



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

PUNIM MASTERI

TEMA: BOTA POETIKE E LASGUSH PORADECIT

LËNDA: ANALIZA E TEKSTIT LETRAR

Mentori:

Prof. Dr. Zeqir Kadriu

Kandidatja:

Igballe Kuka

Tetovë, 2020

Falënderim

Mirënjohje dhe falënderim shkon për të gjithë profesorët e Universitetit të Evropës Juglindore për këshillat dhe njohuritë që na ndihmuan aq shumë.

Një falënderim shumë i veçantë shkon për udhëheqësin tim shkencor që më ndihmoi aq shumë gjatë këtij rrugëtimi, faleminderit Prof. Zeqir Kadriu!

Gjithashtu falënderimi im shkon dhe për familjen time e cila më dha shumë kurajo dhe mbështetje gjatë studimeve, dhe pa harruar shoqërinë time pa të cilët këto vite të studimeve s'do të kishin kuptim.

Abstrakt

Në këtë punim me titull “Bota poetike e Lasgush Poradecit” kemi studiuar punën krijuese të poetit. Pra, qëllimi i këtij punimi është trajtimi i botës poetike të poetit tonë të mirënjohur Lasgush Poradeci, përkatësisht poezisë së tij. Në punim do të bëhet përpjekje të hyhet në labirintet e botës poetike të kësaj poezie, me shpresë se do të arrihet të ndihmohet kuptimi i plotërisë së vlerave të krijimtarisë imagjinative të Lasgush Poradecit.

Bota poetike e Lasgush Poradecit që ofron poeti është e gjerë, e thellë, me krijimin e yjeve në qiell, me nënbotë me prezencën okulte të Zotit, të frymës, qëllimit, tek historia, epika, dashuria dhe deri tek liqeri, mëngjeset, mbarimet e vjeshtës, me zogjtë dhe lulet, dashurinë dhe mërgimin shpirtëror, mallin vjershëtorit.

Sa i përket strukturës, ky punim ndahet në dy pjesë: Në pjesën e parë, pjesën kryesore të punimit, kemi shpërfaqur botën poetike të Lasgush Poradecit, kështu duke u zgjeruar në sistemin poetik, format poetike, lëvizjen poetike dhe stilin, figurat elementare etj.; Ndërkaq në pjesën e dytë kemi analizuar poemat e Lasgush Poradecit.

Fjalët kyçe: *poezi, poetikë, krijues, letërsi moderne.*

Abstract

In this paper entitled "The Poetic World of Lasgush Poradeci" we have studied the creative work of the poet. So, the purpose of this paper is to address the poetic world of our renowned poet Lasgush Poradeci, namely his poetry. The paper will attempt to get into the labyrinths of the poetic world of this poetry in the hope that it will help to understand the fullness of the values of Lasgush Poradeci's imaginative creativity.

The poetical world of Lasgush Poradeci that the poet offers is vast, profound, with the creation of stars in the sky, underwritten by the occult presence of God, of spirit, purpose, in history, epic, love, and until the lake, the mornings, the endings. autumn, with birds and flowers, love and spiritual exile, poisonous longing.

In terms of structure, this work is divided into two parts: In the first part, the main part of the paper, we have exposed the poetic world of Lasgush Poradeci, thus expanding on the poetic system, poetic forms, poetic movement and style, elemental figures, etc. ; In the second part we have analyzed the poems of Lasgush Poradeci.

Keywords: *poetry, poetry, creator, modern literature.*

Përmbajtja

Falënderim.....	2
Abstrakt	3
Abstract.....	4
Hyrje.....	7
Qëllimet e punimit.....	8
Metodologjia	8
Struktura e punimit.....	9
1. Jeta dhe vepra e Lasgush Poradecit.....	10
1.1. Jeta.....	10
1.2. Ndërtimi dhe botimi i vëllimeve “Vallja e Yjeve” dhe “Ylli i Zemrës”	11
2. Poetika e Lasgush Poradecit.....	14
2.1. Sistemi poetik.....	14
2.2. Simbolika e valles	23
2.3. Format poetike-klasike	25
2.4. Format klasike: Oda, Himni.....	27
2.5. Lëvizja poetike dhe stili	29
2.6. Figurat elementare.....	31
2.6.1. Figurat stilistike	33
2.7. Fuqia e artit poetik lasgushian.....	39
2.8. Moderniteti dhe risitë e poetikës së Lasgush Poradecit	41
2.9. Përfundime mbi poetikën lasgushiane	42
3. Poemat e Lasgushit Poradecit	45
3.1. Ekskursioni teologjik i Sokratit.....	45
3.2. Kamadeva.....	53
3.3. Mbi ta	58
3.4. Poemat e Lasgushit dhe situatat e kuptimet në këto tekste	63
3.4.1. Poemat si mesazh kuptimi	66
3.4.2. Poemat dhe figurat elementare.....	69
3.5. Tema në poemat e Lasgush Poradecit	71
3.5.1. Poemat me temë alegorike-etike	71
3.5.2. Tema e dashurisë.....	74

3.5.3. Poema me temë epiko-historike.....	76
3.6. Përfundime mbi poemat e Lasgushit.....	77
Përfundimi.....	79
Literatura.....	81

Hyrje

Nga Aristoteli e këndej, poetika ka qenë në qendër të venerive dhe të shqyrtimeve letrare. Ajo edhe sot vijon të jetë një ndër disiplinat më interesante e më të koklavitura të shkencës së letërsisë.

Poezia e Lasgush Poradecit edhe sot zgjon kureshtjen e lexuesve, është fort preokupative, andaj edhe munda që të kundrohet në tërësinë sistemore të konstantave vlerësuese, mbase nuk është i gjithi në kundërshtim me jetësimin e krijimtarisë artistike. Me këtë shpresë se nuk do të dëmtohet tërësia.

Lasgush Poradeci është njëri nga poetët më të mëdhenj të letërsisë kombëtare, vepra e tij ka lënë gjurmë të madhe në letërsinë shqipe. Në veprën e këtij romantiku të fundit të letërsisë sonë jetoi shqetësimi atdhetar i mbrojtjes së kombit dhe traditës së Rilindjes, ashtu sikurse edhe dëshira për triumfin e pikëpamjeve demokratike, shqetësimi për një emancipim të përgjithshëm kulturor e shpirtëror të shoqërisë shqiptare. Ai është nga lirikët tanë më të mëdhenj, i cili u shqua për ndjeshmërinë dhe ëmbëlsinë poetike me të cilën i këndoi Shqipërisë dhe dashurisë, e kjo është arsyeja që më ka shtyrë të përzgjedh këtë temë masteri.

Llazar Gusho, alias Lasgush Poradeci, që me krijimet e para goditi në shenjë. Ai zgjoi interes të posaçëm ndër shtresa të ndryshme lexuesish. Vepra e tij letrare u bë objekt receptimi aktiv pas botimit sporadik të poezive të tij të para në shtypin e kohës gjatë viteve '30. Botimi i vjershave ishte një faktor që ndikoi dukshëm në kërshërinë e lexuesve. Duhet të themi se atij i paspru jehona e vlerës artistike të poezive dhe përjetimi i thellë estetik që krijohej prej tyre, në horizontin pritës.¹

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi i botës poetike të poetit tonë të mirënjohur Lasgush Poradeci, përkatësisht poezisë së tij. Në punim do të bëhet përpjekje të hyhet në labirintet e botës poetike të kësaj poezie, me shpresë se do të arrihet të ndihmohet kuptimi i plotërisë së vlerave të krijimtarisë imagjinative të Lasgush Poradecit.

Bota poetike e Lasgush Poradecit që ofron poeti është e gjerë, e thellë, me krijimin e yjeve në qiell, me nënbotë me prezencën okulte të Zotit, të frymës, qëllimit, tek historia, epika,

¹ Ilir Shyta, "Receptimi i poezisë së Lasgush Poradecit". Tiranë, 2015 (Disertacion), f. 136

dashuria dhe deri tek liqeri, mëngjeset, mbarimet e vjeshtës, me zogjtë dhe lulet, dashurinë dhe mërgimin shpirtëror, mallin vjershëtorit.

Së këndejmi, do të shtrohen edhe çështje të tjera lidhur me vizionin e tij për letërsinë e sidomos për poezinë në raport me gjinitë e tjera letrare. Mendimi i tij, motivimi, stili, gjuha, individualiteti e shumëçka tjetër që e bën të veçantë këtë poet. Gjithashtu në këtë kontekst, shtrohen edhe mendimet e tij përparimtare, vendosmëria e tij përballë regjimit komunist, veti me të cilat vihet në pah pozicioni inteligjent dhe qëndrimi i tij kundrejt rrjedhave të kohës.

Për poezinë e Lasgush Poradecit janë bërë studime të shumta, sidomos tri dekadat e fundit që kanë sjellë përfundime e konstatime të ndryshme, duke e vlerësuar lart atë për motivet, temat, stilin, e gjuhën e trajtuar. Poezia e tij disponon vlera të padiskutueshme ideo-artistike, figuracion të pasur, shprehje të rrallë e ligjërime me një gjuhë të përzgjedhur.

Qëllimet e punimit

Qëllimet e këtij hulumtimi janë:

- Të njihemi më mirë me autorin Lasgush Poradecin dhe veprimtarinë e tij
- Të thellohem më gjerësisht në analizën e dy vëllimeve: “*Vallja e Yjeve*” dhe “*Ylli i Zemrës*”
- Të gjenden temat që trajtohen në këto vëllime
- Të analizojmë se ku është frymëzuar autori për të shkruar vëllimet, si dhe çfarë qëllimi ka pasur, çfarë mesazhi ka dashur të dërgojë te lexuesi

Metodologjia

Për të realizuar këtë punim masteri, burim kryesor i të dhënave ka qenë kërkimi në literaturë. Pra, metoda e mbledhjes së të dhënave në këtë punim është e tipit rishqyrtim literature. Për përfundimin e punimit janë shfrytëzuar librat nga biblioteka të ndryshme dhe burime të ndryshme shkencore nga interneti. Literaturën të cilën e kemi përzgjedhur ka qenë e bazuar në problematikën që shtjellohet në punim.

Struktura e punimit

Sa i përket strukturës, ky punim ndahet në dy pjesë:

- Në pjesën e parë, pjesën kryesore të punimit, kemi shpërfaqur botën poetike të Lasgush Poradecit (bota të cilën e ofron poeti është e gjerë, e thellë, me krijimin e yjeve në qiell, me nënbotë me prezencën okulte të Zotit, të frymës, qëllimit, tek historia, epika, dashuria dhe deri tek liqeri, mëngjeset, mbarimet e vjeshtës, me zogjtë dhe lulet, dashurinë dhe mërgimin shpirtëror, mallin vjershëtorit), kështu duke u zgjeruar në sistemin poetik, format poetike, lëvizjen poetike dhe stilin, figurat elementare etj.;
- Ndërkaq në pjesën e dytë kemi analizuar poemat e Lasgush Poradecit. Tri poemat, të cilat janë temë e këtij punimi master: “Kamadeva”, “Ekskursioni teologjik i Sokratit” dhe “Mbi ta”, ndonëse janë shkruar në një kohë të rëndë për autorin, në kohën kur e kishte mundur pleqëria dhe kur ishte harruar nga koha, janë vepra të cilat edhe një herë përtërijnë ndjenjat dhe shkrimet e rinisë së autorit, vrullin e tij për dashurinë, ndjenjat, mallin, të dashurën, trimëritë e heronjve, etikën, moralin, e gjithë kjo përmes shkrimit të figurshëm, gjuhës së pastër shqipe.

1. Jeta dhe vepra e Lasgush Poradecit

1.1. Jeta

Lasgush Poradeci është poet lirik modern, që në letërsinë shqipe sjell një frymë të re të poezisë, një konceptim të ri të figurës dhe një shprehje artistike të pasur me fjalë të reja poetike.

Llazar Sotir Gusho i njohur me pseudonimin Lasgush Poradeci, lindi më 27 dhjetor të vitit 1899 në Pogradec. Pothuajse pjesën më të madhe të jetës e kaloi në vendlindjen e tij në Pogradec në një varfëri dhe i anatemuar nga regjimi komunist. Si person i pabindur dhe mospajtues me regjimin dhe vdes në Tiranë më 12 nëntor të vitit 1987.²



Mbas mbarimit të shkollës fillore në Pogradec, i ati i Lasgushit që ishte patriot dhe arsimdashës e dërgoi në moshën 9-vjeçare për të vazhduar studimet në Liceun Rumun të Manastirit (Bitola). Me fillimin e Luftës së Parë Botërore, Liceu u mbyll, dhe ai (Lasgushi) u kthye në 1915 në Pogradec duke e lënë Liceun të pambaruar. I ati që nuk e shihte dot të birin pa shkollë e dërgoi në Athinë, ku më pas ai regjistrohet në një Lice francez. Atje sëmuret nga mushkëritë dhe për dy vjet qëndron i shtruar në sanatoriumin “Sotiria”. Përsëri nuk e mbaron liceun. Në vitin 1921 ai shkoi në Bukuresht (Rumani), për të vazhduar studimet e lëna të papërfunduara. Duke qenë pa bursë dhe pa asnjë ndihmë, ai u detyrua të punonte dhe njëkohësisht të studionte. Në Bukuresht ai u lidh me lëvizjen atdhetare të kolonisë shqiptare, u miqësua me Asdrenin e atdhetarë të tjerë shqiptarë dhe u zgjodh edhe sekretar i përgjithshëm i Kolonisë. Në Rumani, duke dhënë provimet, mori bacalaureatën në Silistra. Në verën e vitit 1924 Qeveria e Fan Nolit i dha bursë dhe ai regjistrohet në Universitetin e Gracit (Austri), në Universitetin “Karol Francik” dhe më 1934 përfundon studimet e larta në Grac (Austri) në Fakultetin e Filologjisë Romano-Gjermane dhe fiton titullin Doktor-Profesor.³ Në dallim nga poetët e Rilindjes, që megjithë origjinalitetin e tyre kishin tipare të përbashkëta, poetët e shquar të periudhës së Pavarësisë si: Noli, Fishta, Poradeci, Migjeni,

² Emin Kabashi, Lasgush Poradeci: Jeta dhe vepra. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1997, f.10.

³ Ilir Shyta, Bibliografi e autorizuar për jetën dhe veprën letrare të Lasgush Poradecit, f.25

janë krejtësisht të ndryshëm nga njëri-tjetri si nga formimi dhe prirja e tyre, ashtu edhe nga interesat e synimet. Lasgush Poradeci e jetoi Rilindjen në periudhën e shpërthimit të kryengritjeve të mëdha për liri.

Ai është nga lirikët tanë më të mëdhenj, i cili u shqua për sensibilitetin dhe ëmbëlsinë poetike me të cilën i këndoi Shqipërisë dhe dashurisë. Në vitin 1933 u botua vëllimi i tij i parë “*Vallja e Yjeve*”, dhe më 1973 u botua vëllimi i dytë “*Ylli i Zembrës*”. Pas Luftës së Dytë Botërore, Lasgush Poradeci e vazhdoi veprimtarin krijuese, por u mor edhe me përkthime. Ai shkroi, veç të tjerash, poemat “*Eskursioni teologjik i Sokratit*”, “*Mbi ta*”, “*Kamadeva*”, e po ashtu baladat për Muharrem e Reshit Çollakun. Gjithashtu, përktheu edhe disa nga kryeveprat e letërsisë botërore si Eugjen Onjeginit të Pushkinit, lirikat e Lermontovit, të Bllokut, poemat e Hajnes, të Majakovskit e Miçikieviçit, lirikat e Gëtes dhe Hajnes, poezi të Lanaut, Brehit, Hygoit, Mysësë, Bajronit, Shellit, Bërnsit, të Emineskut etj.

Lasgush Poradeci lë pas një krijimtari të bukur, e cila kishte fituar zemrën e lexuesit dhe kishte tërhequr vëmendjen e disa studiuesve të shquar të kulturës sonë si Eqrem Çabej, Skënder Luarasi, Mitrush Kuteli, Sabri Hamiti, Ismail Kadare, Rexhep Ismajli etj. Si një personalitet i shquar dhe poet i vërtetë ai nuk ua nënshtroi kurrë artin e tij kërkesave dhe synimeve të diktaturës. Për këtë arsye ai u la në një gjendje ekonomike të rëndë dhe pothuajse në harresë nga shtypi zyrtar. Vetëm në vitin 1989 mundi të botohet vepra e tij e plotë. Duhet të themi me bindje dhe me krenari se emri i Lasgush Poradecit është një nder për kombin shqiptar. Poradeci është një poet lirik që solli në letërsinë shqiptare një ndjeshmëri të veçantë të fjalës dhe poezisë. Krijimtaria poetike e tij dallohet në tri aspekte kryesore: në poezinë filozofike, patriotike dhe erotike. Vepra e Lasgush Poradecit i përket atyre veprave të cilave koha nuk ua zbehu dhe humbi rëndësinë. Por vepra e tij është shumë jetëgjatë “poezia e Lasgush Poradecit është një univers i tretur në fjali”.⁴

1.2. Ndërtimi dhe botimi i vëllimeve “*Vallja e Yjeve*” dhe “*Ylli i Zembrës*”

Lirikat më të fuqishme të Lasgushit e kaluan një shekull të qetë.⁵ Deri në vitin 1925 ai kishte botuar poezitë: “*Naimit*”, “*Gjuha e zjarrit*”, “*Zog i qiejve*”, “*Lundra dhe flamuri*”, dhe dhjetëra poezi ku adhurohet natyra shqiptare ku zien jeta nga zjarri i dashurisë dhe i bukurisë,

⁴ Ilir Shyta, Bibliografi e autorizuar për jetën dhe veprën letrare të Lasgush Poradecit, f.26

⁵ Eldon Gjika, Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit, “*Naimi*”, Tiranë, 2010, f.84,85

ku vasha shqiptare mbetet gjithnjë e menduar mirë dhe trimi shpirtdjegur. Cikli poetik Vallja e Përjetësisë i Lasgush Poradecit shfaqet si pjesë e përmbledhjes “Vallja e Yjeve”, votuar nën kujdesin e Mitrush Kutelit në vitin 1933.

Katër nga pesë poezitë e ciklit, përpara se të përfshiheshin në këtë vëllim, konkretisht *Fryma dhe Qëllimi, Ndjenja dhe Njeriu, Njeriu dhe Zoti, Përjetësia* gjendeshin të botuara në gazetën “Shqipëria e Re: më 11 korrik 1926, me tituj të tjerë, respektivisht *Jeta, Njeriu, Zoti, Aternitas*. Mes variantave të poezive botuar në gazetë dhe variante të botuara tek “Vallja e Yjeve” ndryshimet nuk qëndrojnë vetëm te titujt e tjerë, por edhe në shumë elemente të tjera. Në vitin 1937, po nën kujdesin e Kutelit, botohet rishtas në Bukuresht, përmbledhja tjetër me poezi e Lasgush Poradecit “Ylli i Zembrës”. Ky botim përmban 19 poezi të marra nga vëllimi paraardhës, krijime të reja të Lasgushit, si dhe krijime që nuk ishin përfshirë në vëllimin “Vallja e Yjeve”. Në përmbledhjen e “Ylli i Zembrës”, cikli emërtohet *Zemra e Përjetësisë* dhe përbëhet nga dy poezi, *Ndjenja dhe Njeriu*, që gjendet edhe tek “Vallja e Yjeve” dhe nga Përjetësia, e cila, në krahasim me Përjetësia e mëparshme 1944 vepra e Lasgushit njihet botime të pjesshme, si dhe sprova për botime tërësore. Në të parat, ciklet *Vallja e Përjetësisë* dhe *Zemra e Përjetësisë* janë të përjashtuara. Në përmbledhjen “Vdekja e Nositit”, botuar nën kujdesin e Sabri Hamitit, poezitë e ciklit (përjashtuar gabimet tipografike) paraqiten identike me botimet e vitit 1933 dhe 1937. Në botimin “Vepra letrare”, Tiranë 1989 nën kujdesin e Frida Idrizit, poezitë e ciklit, por edhe poezitë e tjera, botohen duke ndërhyrë në ortografi, në strukturë fonetike e gramatike.⁶

Botimi i veprave të Lasgush Poradecit përgatitur nga Vath Korteshi, “Vepra i përfshinë poezitë e ciklit *Vallja e Përjetësisë* dhe *Zemra e Përjetësisë*, në variantin e botimeve të “Vallja e Yjeve” dhe “Ylli i Zembrës”.

Në mbarim të vitit 1932 Kuteli merr përsipër dhe realizon botimin e përmbledhjes “Vallja e Yjeve”, i ndihmuar nga Shoqëria e Studentëve Shqiptar në Rumani, kryetar i së cilës ishte vetë. “Ylli i Zembrës” botohet në tirazh prej 2000 kopjesh, i cili i dërgohet Lasgushit. Ky shpërndan në shitje në disa librari në Tiranë, Shkodër, Korçë.⁷

Ndërkaq në vitin 1939 është vetë Lasgushi që bënë një ribotim të “Ylli i Zembrës”, me një tirazh 2000 kopje, por kësaj here në Tiranë në shtypshkronjën “Luarasi”. Roli i Kutelit në

⁶ Ali D. Jasiqi, “Poezia popullore dhe lirika e Lasgush Poradecit”, Revista letrare – JETA E RE.

⁷ Moikom Zeqo, “Të dhëna të reja për Lasgush Poradecin”. Bashkimi Tiranë, 1991, f.67

botimin e poezive të Lasgushit ka një rëndësi të zakonshme, duke i kryer një shërbim të vyer letërsisë shqiptare.⁸

Vallja e Yjeve ka këtë strukturë ciklore:

- 1) (Në vend të parafjalës) Zog' i qiejve
- 2) Vallja e qiellit
- 3) Vallja e dherit
- 4) Vallja e yjeve
- 5) Vallja e përjetësisë
- 6) Vallja e vdekjes
- 7) Kur nuk ndjehesh fare mirë

Ylli i Zemrës ka këtë strukturë ciklore:

- 1) Zemra e qiellit
- 2) Zemra e dherit
- 3) Zemra e jetës
- 4) Zemra e përjetësisë
- 5) Zemra e vdekjes
- 6) Kush ma njohu dhembshurinë

⁸ Eldon Gjokaj, *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit, "Naimi"*, Tiranë, 2010, f.90

2. Poetika e Lasgush Poradecit

Në punim do të bëhet përpjekje të hyhet në labirintet e botës poetike të kësaj poezie, me shpresë se do të arrihet të ndihmohet kuptimi i plotërisë së vlerave të krijimtarisë imagjinative të Lasgush Poradecit.

Poezia e Lasgushit ofron mundësi të bollshme spekulimi por është terren rrëshqitës, ngase mund të ikën mendimi në zbrazëti impulsive. Kujdesi i përhershëm, mbase sërish nuk do të ketë mundësi ta ruajë kontinuitetin e përdorimit të parimeve të ndryshme të ndonjë metode, të ndonjë teorie, sepse poezia bën jetën e saj edhe jashtë logjikës së përditshmërisë.

2.1. Sistemi poetik

- Lasgushi krijon një sistem poetik vetanak,⁹ i cili sintetizon të gjithë ideologjinë e tij;
- Qendra e këtij sistemi është “cikli filozofik” (“Vallja e përjetësisë”, “Zemra e përjetësisë”);
- Elementet, përkatësisht ciklet poetike dhe poezitë që i përbëjnë, janë konceptuar dhe funksionojnë në mënyrë organike në varësi dhe në plotësi me njëri-tjetrin;
- Organiciteti i njëmendësuar në rrafshin semantik dhe në rrafshin formal është më i konsoliduar në qendrën e sistemit

Sistemi poetik tek vëllimi poetik: “Vallja e Yjeve” dhe “Ylli i Zembrës”

Vallja e Yjeve është strukturuar në shtatë cikle, përkatësisht:

- I.** NË VËND PARAFJALE (1. Zog’ i qiejve);
- II.** VALLJA E QIELLIT (2. Shpirtit, 3. Ri mbështetur në tryezë);
- III.** VALLJA E DHERIT (4. Kënga pleqërishte, 5. Poradeci, 6. Naimit, 7. Naim Frashërit, 8. Marshi i Djalërisë, 9. E fundit mërziqje, 10. Mëngjes, 11. Korrik, 12. Mbarim vjeshte, 13. Dimër, 14. Gjahtori);

⁹ Eldon Gjokaj, *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit, “Naimi”, Tiranë, 2010, f. 59-60.*

- IV.** VALLJA E YJEVE (15. Malli i Vjershëtorit, 16. Trioleta, 17. Kroj i fshatit t'onë, 18. Syt' e lumtur, 19. Syt' e varfëruar, 20. Balladë, 21. Mbretërija jonë, 22. Vallja e luleve, 24. Ah me atë mall që më ke ti, 25. Ku shtrohet vala, 26. Syt' e tu vetëmitarët, 27. Një yll përjetësie, 28. Eja motër, 29. Mbretërija e zemrës, 30. Vdekja jonë, 31. Rri m shendet, 32. Mërgim, 33. Të ritë-e viteve të mi, 34. Kur të jesh e zemëruar, 35. Malli, 36. Rresurrectio, 37. Letërkëmbim, 38. Që larg, 39. Vallja e yjeve);
- V.** VALLJA E PËRJETËSISË (40. Vallja e përjetësisë, a) Lënda dhe Jeta, b) Fryma dhe Qëllimi, c) Ndjenja dhe Njeriu, ç) Njeriu dhe Zoti, d) Përjetësia);
- VI.** VALLJA E PËRJETËSISË E VDEKJES (41. Gjeniu i Anijes, 42. Lundra dhe Flamuri, 43. Vdekja e Nositit, 44. Vajtim mbi trupin e shokut, 45. Kur qajnë motrat të vëllanë);
- VII.** KUR NUK NDJEHESH FARE MIRË (46. Kur nuk ndjehesh fare mirë).

Secili cikël përfshinë poezi që bashkohen prej një dominanteje semantike, sipas një programi të paracaktuar dhe të artikuluar nga autori.

Si program i paracaktuar dhe i artikuluar i cikleve të vëllimit *Vallja e Yjeve* shërben poezia e vetme e ciklit të parë *Në vendë të parafjalëve, "Zog' i Qiejve"*.

Në poezinë "Zog i Qiejve"¹⁰ Lasgushi këndon në një dekor stilistik të madhërishtë, metafizike – edhe Përjetësinë, sikush prej tyre të zhvilluara pastaj në kaptina të veçanta në *Vallën e Yjeve* dhe në *Yllin e Zemrës*.

Figurativisht (Zog' i Qiejve) i përngjan edhe një karte gjeografike e cila tregon gjithë pamjet fizike e gjithë konceptin metafizik të Lasgushit.¹¹

Programi i lëndës poetike lasgushiane në poezinë "Zog i Qiejve" hetohet përmes një rruge të thjeshtë arsyetimi: fillimisht përcaktohet *dominantja semantike* e çdo cikli, e cila shërben si unifikuese e poezive të veçanta kësaj mënyre përfitohet një *rrjetë e dominantes semantike* të vëllimit, më pas shqyrtohet prania, ose jo e kësaj rrjete në poezinë "Zog' i Qiejve". Në këtë rast *dominantja semantike* është leksema në gjendje të sintetizojë më maksimalisht se të tjerat

¹⁰ Eldon Gjokaj, *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit, "Naimi"*, Tiranë, 2010, f. 59-60.

¹¹ Moikom Zeqo, "Të dhëna të reja për Lasgush Poradecin". *Bashkimi Tiranë*, 1991, f.79

spektrin semantik të poezive që përbëjnë një cikël. Përcaktimi i *dominanteve* rezulton një punë e thjeshtë sepse shumicën e tyre autori i jep vetë që në titullim. Duke përjashtuar ciklin e parë si programtiv, atëherë në ciklin **II. VALLJA E QIELLIT**, dominantja semantike është qielli, në ciklin **III. VALLJA E DHERIT**, dominantja semantike është dheri, në ciklin **IV. VALLJA E YJEVE**, dominantja semantike është ylli, në ciklin V. Vallja e përjetësisë, dominantja semantike është përjetësia, në ciklin **VI. VALLJA E VDEKJES**, dominantja semantike është vdekja. Sa i takon ciklit **VII. KUR NUK NDJEHESH FARE MIRË**, që përmban vetëm një poezi, me titull të njëjtë me cikël mendoj se kemi të bëjmë me një vetërrëfim poetik, ku si me thënë, bëhet bilanci i realizimit të programit poetik. Në këtë prizëm tipologjikisht cikli **VII.** krijon lidhje analogjike me ciklin I dhe të dy së bashku “mëvetsohen” nga pjesë të tjera. Kjo dikotomi duhet përfytyruar gjithnjë në kuadër të organicitetit sistemor të vëllimit, i cili na çaset këtu në trajtën më të thjeshtë, njëkohësisht më të plotë evolutive: *program poetik-lëndë poetike-bilanc i realizimit poetik*.¹²

Dominatet semantike të pesë cikleve japin dorë të radhiten pesë strukturat poetike që në korrelacion me njëra-tjetrën krijojnë unitetin e ideologjisë lasgushiane.

Duke iu referuar Kutelit, thelbi kuptimor i ciklit **II. VALLJA E QIELLIT** është invokacioni i inspiratës, i frymës së lartme dhe zbritja e saj mbi poetin. Kjo dominancë kuptimore shtrihet në të dyja poezitë e ciklit “Shpirtit”, “Ri mbeshtetur në tryezë”.

Cikli **III. VALLJA E DHERIT** (me dominante semantike dherin), përmbledh përshkrimin e këndimit të Atdheut *fizik*. Është Shqipëria fizike vetë me qiellin e saj, me tokën e saj-male, brigje e fusha, me lumenjtë, liqenet, detet, me magjinë e stinëve të veta me mëngjeset, ditët e netët e saj, ose me pak fjalë, *gjithë bukuritë, stolitë e magjitë e mëmëdheut shqiptar*.

Atdheu metafizik është Shqipëria tjetër,¹³ Shqipëria shpirtërore: gjuha shqipe me thesaret e stolitë e saj të paçmueshme, këngët e lashta me atë njomësi e thellësi pa shoqe heronjtë e pavdekur, përvojitet, lotët e gjaku i kombit, trimëritë, bujaritë, e virtytet e tij, eshtrat e etërve, gjyshërve e stërgjyshërve, koha e kaluar e m’vretur dhe koha e ardhme e kthjelltë.

Cikli **IV. VALLJA E YJEVE**, (me dominante semantike yllin (mallin, dashurinë), i kushtohet motivit bazik të poetikës lasgushiane, “dashurisë”, i cili “zotëron pjesën më të madhe të veprës”. “Dashuria konceptohet si një ndjenjë e ndërlikuar që rrok botën njerëzore dhe

¹² Jeta e Re, Revistë letrare, “Lasgush Poradeci”, Prishtinë 1999.

¹³ Eldon Gjokaj, Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit, “Naimi”, Tiranë, 2010, f. 63.

kozmosin. Në botën njerëzore dashuria lasgushiane qaset si një ndjenjë sublime bipolare, magjisë, dhembjes e cila sintetizohet në “mallin” e mirënjohur në hapësirën kozmike dashuria shfaqet si një kusht ekzistencial për ekuilibrimin e kaosit kozmik, si fillesë dhe fund njëkohësisht.

Cikli **V. VALLJA E PËRJETËSISË** (me dominante semantike përjetësinë), në pesë këngët që përbëjnë, paraqet “pesë shkallët e zhvillimit të jetës fiziko-psikike”.

Cikli **VI. VALLJA E VDEKJES**, (me dominante semantike vdekjen, flijimin) përmes triptikut “Gjeni i Anijes”, “Lundra dhe Flamuri”, “Vdekja e Nositit”, transmeton tërë vizionin jetësor të poetit orientuar sipas idealit. Në këtë mision tokësor dhe hyjnor, vdekja është element përplotësues i idealit, kusht për mbërritjen e përjetësisë.

Në poezinë programative “Zog’ i Qiejve”, përmes një shqyrtimi të orientuar vertikalisht gjenden të gjashta dominantet semantike. Qielli, bota qiellore, jo vetëm që është e rrokshme sakaçë, por qëndron në thelb të krejt poetikës së tekstit. Kjo botë shfaqet e konkretizuar te përkushtimi i poetit (bilbili) ndaj Zotit, burimi i inspiratës poetike:¹⁴

Këng’ e ti mëment i thyet ngjan kulluar posi këng’ e Zotit Vetë.

E prandaj duke filluar, aty Lart i shpije kryet

Dh’i ngreh sipër –e-më-sipër gjer sa qafa ment i thyet,

Asohere-e ndjej si dridhet më një zë pa shembëllim,

Asohere-e ndjej si foli: Të jam falë, -o Zoti im!

Në vijim ndeshet dheri, bota tokësore me të gjitha bukuritë e saj, realitet i panjohur dhe i çuditshëm për poetin e zbritur nga hapësirat qiellore

Ay sheh që nëpër fletë me vështrimin e quditur

Ndaj qkëlqen ner mijë ngjyra Vënd’ ti ku pati sbritur,

E pra ja q’i mbylli sytë, e që gojzën e hapi:

Tungjatjeta! tungjatjeta! Vënd o Vënd ku qel junapi!

Haj Bilbil, se Vëndi jonë ka liqere-e anë detesh,

Nëpër bimëzat e tyre po vërej si qan detesh,

Po dëgjoj prej largësire, si nër male-si nër fusha,

Si në kopshte jaragvanësh dhemshurisht të fryhet gusha;

¹⁴ Mensur Raifi, “Lasgushi, Noli, Migjeni”, Rilindja, 1986.

Bota tokësore,¹⁵ përveçse në rrafsh perceptues, vepron mbi poetin edhe në rrafshin shpirtëror. Pasi ka njohur bukuritë fizike ai provon një ndjenjë të re që nuk e ka njohur më parë, dashurinë, mallin si bipolaritet magji-dhëmbës,

*E si rron në gjë të dherit dit-për-ditë-a nat –për-natë,
Gjir ‘i dherit ku rreh jeta të fal breng e përgjate:
Se prej mallit që të thyen përmes pamjeve të tija,
Mun në fundë të zemrës s’ate ritet fshehur dashurija.
E si rritet prej së fellash më një qas fillon të nisë
Kënga jote- e papandehur q’është fjal’dashurisë.*

Më tej haset introspeksioni i poetit. Pasi ka kënduar dashurinë ai tashmë shqetësohet për botën e mendimet përjetësinë, të vërtetën:

*Asohere kënga jote shuhet dyke psherëtitur;
Ti fillon t’a rrahish mëndjen, buqet me shpirt të rritur.
Nër paanësi të nsrinjë yjt’e ndezur varg-varg:
Ti me mall të paqetur fluturon larg e-me-larg...*

Prania e dominantes semantike të ciklit VI. Vallja e vdekjes, kërkon një interpretim më të thelluar. Sikundër është theksuar më sipër cikli VI me triptikun alegorik “Gjeniu i Anijes”, “Lundra dhe Flamuri”, “Vdekja e Nositit”, transmeton misionin e poetit dhe flijimin e tij për mbërritjen e stadi të përjetësisë këtij misioni. Në poezinë programative “Zog’ i Qiejve” motivi i flijimit fizik mungon, por kjo mungesë mbushet plotësisht prej pranisë së stadi të përjetësisë që mbart misionin e poetit.¹⁶

*Që nga bota njerëzore, ku këndoj me shpirtin plot,
Prit-e, prit! se po ‘t afrohet Zog ‘i Qiejve, o Zot!
Fal –i Këngëtor-finoshit Gas të Thjeshtë mun në gjë:
Pasi lot në rreze djelli ndrit-e në Përjetësi!*

Nga analiza e mësipërme arrihet në përfundim se poezia programative¹⁷ “Zog’ i Qiejve” përqendron semantikisht dhe paralajmëron tërë lëndën poetike lasgushiane të vëllimit *Vallja e Yjeve*. Sistemi poetik i Lasgushit mund të përfytyrohet si një konstelacion me pesë elementet,

¹⁵ Eldon Gjikalj, *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit*, “Naimi”, Tiranë, 2010, f. 64.

¹⁶ Ali D. Jasiqi, “Poezia popullore dhe lirika e Lasgush Poradecit”, *Revista letrare – JETA E RE*.

¹⁷ Eldon Gjikalj, *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit*, “Naimi”, Tiranë, 2010, f. 65-66.

të vendosur në një raport të plotësive dhe varësisë, bashkësi në zhvillim ku elementet nuk lidhen në mënyrë statike, por sipas një dinamike që i integron ato në bashkësi.

Vëllimi “Ylli i Zemrës” përbëhet nga gjashtë cikle poetike:

I. ZEMRA E DHERIT (1. Ylli, 2. Gjumi i shpirtit, 3. Gjuha e zjarrtë);

II. ZEMRA E DHERIT (4. Dremi liqerit, 5. Zemra e liqerit, 6. Dritë fshetësie, 7. Poradeci, 8. Kënga pelqërishte RASPODI POPULLLORE, 9. Bjenë telat, 10. Qu mbush mali, 11. Dita e Njëzëtetes, 12. Asdreni)

III. ZEMRA E JETËS, ERË TRËNDELINË (13. Vogëlushja, 14. Malli i largë, 15. Ti moj shoqe, 16. Syr'i fshehur, 17. Vesë dashurije, 18. Si nus' ere, 19. Vashë dhembshurije, 20. Erë trëndelie, 21. Dashurija udhëtare, 22. Je ulur fortë, 23. Oh vanë, fletët, 24. Q' degjoj me sy të trembur, 25. Ti po vjen që prej së largu, 26. Posi burbuq trandafilt, 30. Eja motër, 31. Vdekja jonë, 32. Ëndërr zilitare, 33. Dëshirave, 34. Kur në flakë, 35. Rri me shendet, 36. Lamtumirë, 37. Lamtumirë (variant), 40. Të ritë-e viteve të mi, 41. Kur të më jesh e Zemëruar, 42. Malli, 43. Më zu një mall, 44. Mu zu një mall dhe sot (variant), 46. Që larg, 47. Vallja e Yjeve, VASHA DHE TRIMI, 48. Kroji i fshatit tonë, 49. Vate prilli, 50. Kur mu rrite Vogoloshe, 51. Kush ta fali bukurinë, 52. Në porta nga mulliri, 53. Del në porta, 54. Po qanë vasha në shtëpi, 55. Vallja e luleve, 56. Balladë, 57. Kush po shkon ashtu (Trimi dhe Vasha).¹⁸

IV. ZEMRA E PËRJETËSIS (58. Njeriu dhe Zoti, 59. Përjetësia).

V. ZEMRA E VDEKJES (60. Zemra e shokut, 61. Gjaniu i anijes, 62. Lundra dhe Flamuri, 63. Vdekja e Nositit, 64. Përqaqimi, 65. Zemërat, 66. Prej qdo gazi e hidhërimi).

VI. KUSH MA NJOHU DHEMSHURINË (67. Kush m'a njohu dhemshurinë).

Sistemi poetik në *Ylli i Zemrës* shfaqet analog me atë të *Vallja e Yjeve*.

Përmbledhtazi, duket fare qartë se ruhen të pesta dominatet semntike (qielli, dheri, jeta, ylli-malli-dashuria, përjetësia, vdekja).

VII. KUSH MA NJOHU DHEMSHURINË, që përbëhet nga një poezi homonime, topologjikisht është analog me ciklin përmyllës të vëllimit *Vallja e Yjeve*.¹⁹

¹⁸ Moikom Zeqo, “Të dhëna të reja për Lasgush Poradecin”. Bashkimi Tiranë, 1991, f.55.

¹⁹ Mensur Raifi, “Lasgushi, Noli, Migjeni”, Rilindja, 1986, f.129

VII. KUR NUK NDJEHESH FARE MIRË,²⁰ i përbërë po ashtu nga një poezi homonimie. Në të dy vëllimet janë të vetmet cikle që kanë këtë strukturë. Një zgjidhje e tillë strukturore nga ana e autorit rrjedhon drejtpërdrejt prej kumtit që përcjellin këto poezi, thelb, rrëfim i poetit për arsyet e misionit të tij.

Një përkim kaq i ngulitur kërkon domosdoshmërisht një vështrim krahasues, analitik mes dy vëllimeve, *Vallja e Yjeve* dhe *Ylli i Zemrës*, pse ka shumë gjasa të ofrojë të dhëna me rëndësi.

a. Një pjesë e mirë e poezive të vëllimit *Ylli i Zemrës* janë marrë nga vëllimi i parë *Valla e Yjeve*: 1. Kënga pleqërishte, 2. Poradeci, 3. Kroj i fshatit t'onë, 4. Balladë, 5. Vallja e luleve, 6. Ah me atë mall që ma ke ti, 7. Ku shtrohet vala, 8. Eja motër, 9. Vdekja jonë, 10. Ri me shendet, 11. Të it e viteve të mi, 12. Kur të më jesh zemëruar, 13. Malli, 14. Që larg, 15. Vallja e yjeve, 16. Njeriu dhe Zoti, 17. Gjeniu i anijes, 18. Lundra dhe flamuri, 19. Vdekja e Nositit. Zhvendosja e poezive nga *Vallja e yjeve* në *Yllin e zemrës* rezulton si më poshtë: poezitë “Kënga pleqërishte”, “Poradeci”, pjesë e ciklit VALLJA E DHERIT, bëhen pjesë e ciklit ZEMRA E DHERIT. “Kroi i fshatit t'onë”, “Balladë”, “Vallja e luleve”, “Ah me- atë mall që më ke ti”, “Ku shtrohet vala”, “Eja, motër”, “Vdekja jonë”, “Rri me shëndet”, Të ritë- e viteve të mi”, “Kur të më jesh zemëruar”, “Malli”, “Që larg”, “Vallja e Yjeve”, pjesë e ciklit VALLJA E YJEVE, bëhen pjesë e ciklit ZEMRA E JETËS, “Njeriu dhe Zoti”, pjesë VALLJA E PËRJETËSISË bëhen pjesë e ciklit ZEMRA E PËRJETËSISË; “Gjeniu i Anijes”, “Lundra dhe Flamuri”, Vdekja e Nositit”, pjesa e ciklit VALLJA E VDEKJES, bëhen pjesë e ciklit ZEMRA E VDEKJES.

b. Gjatë zhvendosjes poezitë ruajnë përkatësinë në po ato struktura poetike, duke transmetuar në këtë mënyrë koherencën dhe unitetin e sistemit poetik. Nëse në vëllimin *Vallja e yjeve* matrica që përbashkon të gjithë titujt e cikleve është vallja, në vëllimin *Ylli i zemrës*, matrica përbashkuese është zemra.

c. Analogjia në titullimin e cikleve të të dy vëllimeve prishet vetëm në ciklin II, nga VALLJA E YJEVE në ZEMRA E JETËS. Një nga arsyet është se në dallim nga Vallja e Yjeve ku titulli i vëllimit është i njëjtë me titullimin e njërit cikël nuk mbart titullin e vëllimit. Nga ana tjetër është më se e dukshme statistikisht që ZEMRA E JETËS, i strukturuar me dy nëntituj është cikli më i zgjeruar krahasimisht me *Vallja e Yjeve*.

²⁰ Eldon Gjijak, *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit, “Naimi”*, Tiranë, 2010, f. 67.

d. Përveç zgjerimit të cikleve nga *Vallja e yjeve* në *Yllin e Zembrës*, kemi edhe procedimin e kundërt, rrudhjen e tyre.

ZEMRA E PËRJETËSISË përbëhet vetëm nga dy poezi.

e. Megjithëse ruhet analogjia në emërtim të përbashkët me paraardhësin; ZEMRA E QIELLIT nuk përmban asnjë nga dy poezitë VALLJA E QIELLIT, por ka tri poezi të reja “Ylli”, “Gjeniu i shpirtit”, “Gjuha e zjarrtë”.

Të dhënat e mësipërme shprien në dy konkluzione:²¹

1. Transferimi simetrik i poezive nga *Vallja e Yjeve* në *Ylli i Zembrës* ndodh vetëm pjesërisht (në ciklet VALLJA E DHERIT / ZEMRA E DHERIT / VALLJA E YJEVE / ZEMRA E YJEVE / VALLJA E PËRJETËSISË / ZEMRA E PËRJETËSISË / VALLJA E VDEKJES / ZEMRA E VDEKJES).

2. Nuk ka transferim të lëndës poetike nga njëri vëllim te tjetri, e cila kërkon pazgjidhshmërisht hetimin e lëndës që transferohet, lidhet drejtpërdrejt me atë që e kam artikuluar si raporti sistemor i lëndës poetike lasgushian.

Shtrohet një pyetje themelore: dy vëllimet sendërtojnë nënsisteme poetike që integrohen në makrosistem, apo kemi të njëjtin sistem që plotësohet në mënyrë progresive nga njëri vëllim në tjetrin? Më thjesht: Cilat janë arsyet e këtij transferimi diku më i plotë e diku gjetkë fare mungesor? Si mund të motivohet integrimi i lëndës së vjetër në lëndën e re? I vetmi që është marrë me këtë çështje ishte Mitrush Kuteli. Motivi i parë që jep Kuteli, ka të bëjë me shqetësimin për t’i garantuar lexuesit mundësitë e receptimit të poezisë së Lasgushit. Këtij i shtohen edhe motivet bibliografike dhe filologjike. “Arsyet për të cilat po i radhisim në *Yllin e Zembrës* vjershat e mësipërme janë të ndryshme. Shkaku i parë është se *Vallja e yjeve* e shtypur vetëm në pesëqind copë të përhapura brenda e jashtë Shqipërisë ka arritur sot fort rrallë.

Shkaku i dytë është se më 1933, kundrejt dëshirës sonë disa vjersha patën dalë me gabime shtypi, të cilat pa fjalë e dëmtojnë veprën.

I treti shkak është ai i ndryshimeve që iu solli poeti disa vargjeve të *Valles së yjeve*.

²¹ Eldon Gjikaj, *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit*, “Naimi”, Tiranë, 2010, f. 68.

E katërta dhe e fundit arsye ka qenë dëshira jonë për t'u dhënë lëcitësve ndonjë variant të gjithë asaj vjershe.

Për nga strukturimi formal i poezisë në libër poetik, me këngën hyrëse dhe me shtrirjen ciklore të lidhur, Lasgush Poradeci krijon konceptin e librit si Metaforë dhe në këtë vështrim është i krahasueshëm me Bodlerin dhe librin e tij të ligësisë.²²

Mirëpo, Lasgushi në konceptin formal të shkrimit poetik e të librit, duke vënë në kujtë me të njëjtën dalldisje procesin e krijimit të formës dhe rezultatit e punës poetike, madje një sistem poetik në rrafshin formal e në rrafshin konceptual, i afrohet më tepër konceptit malarman të librit absolut. Kjo shpie kah sistemi i përmbyllur poetik, që reflekton saktësisht një trashëgimi të simbolozimit, e cila duket të jetë realizuar më e plotë në projektet poetike të Pol Valerisë.

Paradoksi ngjet sepse sistemi i Lasgushit nuk është i mbyllur, ai mbetet i hapur, qoftë edhe me kushtin që ky sistem të ketë qenë i projektuar por jo edhe i përfunduar.

Çështja mund të duket po të analizohen titujt e librave të tij poetikë, realë dhe virtualë, që do të ishin shtyllat e sistemit të projektuar. Duke u nisur në temën themelore të poezisë së tij, dashurinë, Lasgush Poradeci e ka ngritur këtë skemë të titujve të veprave poetike:

Vallja e Yjeve – Ylli i Zemrës-Zemra ime – Ime shoqe

Dy titujt e parë janë të librave poetikë që njohim, dhe sic shihet titujt kanë një formulim të figuruar, ata janë metafora sintagmatike. Dy tituj tjerë janë projektuar si libra, të cilat poeti nuk ka arritur t'i përfundojë si sisteme të kryera, ndonëse kanë mbetur shumë poezi në dorëshkrim. Por bie në sy që dy titujt e fundit kanë tendencën e kalimit nga figurimi në eksplikim, apo në vështrimin më të gjerë, nga poeti kalohet te Njeriu, apo në kuptimin themelor të njohjes nga apstraksioni në konkretësi. Në vështrimin e komunikimit të brendshëm të poezisë në sistem, nga dallohet një tendencë për lezim implicit. Kështu, nga titujt ne shohim dramatikën e konkretizimit të figurës nëpër tri shkallë:

Ylli-Zemra-Shoqja

Për të treguar shkalloren e dashurisë në shkallën abstrakte e konkrete, në art e në jetë, në temporalitet e në eternitet, përjetësi.

²² Sabri Hamiti, "Tematologjia", Prishtinë, 2005, f.141-142.

2.2. Simbolika e valles

Lasgush Poradeci është njohës i mirë i lashtësisë kulturore, i lashtësisë historike, është njohës i mirë i shpirtit këngëtar të popullit. Lasgushi si poet nuk ka mundur të rrijë indiferent ndaj begatisë së tyre si vlera. Në këtë rrjedh mund të inkuadrohet edhe njohja e tij e mrekullueshme e disa kulturave të huaja, gjë që ka ndihmuar në rritjen e larushisë poetike të këngës së tij. Pasi e vetmja rrugë e tij jetësore ishte arti, ai me një siguri artisti, duke mos u shkoqur asnjëherë nga tabani i frymëzimit të tij poetik, i ngreh në probleme vlerash artistike disa nga qenësitë e këtyre njohurive. Në poezinë e tij janë prekur disa nga anët esenciale të jetësimit shpirtëror të njeriut nëpër kohë. Ngjashëm me vallen, që prek vertikalisht koekzistimin e dyanshëm: të njeriut dhe të kohës, poezia e tij, tashti si Fjalë, përvijohet nëpër traumat e këtij gjallërimi. Fjala, te Lasgushi, dëshmitarja më besnike e pranisë në kohë dhe në hapësirë, po e një pranie specifike, ka kaluar nëpër të gjitha analizat funksionale të kuptimeve, edhe kozmogonike, të laboratoriumit krijues të Lasgushit. Vlera e këtill e Fjalës, tashti më nuk është vetëm këndim për hir, po është një borxh moralo-krijues që kërkon shpagim të domosdoshëm. Kënga, në këtë kontekst, krijon mundësinë që të kundrohet më realisht edhe tabani i ekzistimit të saj. Ngase vetëm e mbështetur ku duhet, ajo, si gjuhë arti, mundëson qasje për analizim poetik. Sërish, nuk është mirë që këto probleme të poezisë së Lasgushit të përthyhen nëpër analiza të atilla, ku do të vinte në shprehje vetëm ana teknike e krijimit poetik.

Poezia e Lasgushit, është më tepër një vizion sesa realitet, që kthehet përherë si krijim artistik, për ta konsultuar terrenin lashtor të frymëzimit. Vallja poetike e tij, duke mos injoruar asnjëherë burimin lashtor të frymëzimit, sidomos në pjesën më të madhe të krijimeve të tij më të bukura, gjallërinë e plotë, merr vlerë konotative vetëm kur vendoset drejt në kohën kur është krijuar. Andaj, është e kuptueshme, që ndonjëherë lexuesi të ngatërrohet rreth përkatësisë së saj edhe ndjenjore, e të abstraktohet përkatësia e saj si vlerë e një nënqielli të caktuar poetik. Poezia e tij, bijë e momentit të caktuar kohor, bën një ecje karakteristike, si vizion krijues, sa të rralla i ka shoqet në poezinë shqipe, jo vetëm të kohës së tij, por edhe më vonë.²³

Në krijimtarinë e tij gjejmë, përveç titullit të librit, edhe cikle, edhe poezi, që mbajnë në ballë emrin e valles: “Vallja e yjve”, “vallja e luleve”, “vallja e dherit”, “vallja e përjetësisë”, e kështu me radhë. Po të ndiqet me interesim ritmi i valles së këtillë poetike, do të kapej një

²³ Mensur Raifi, “Lasgushi, Noli, Migjeni”, Rilindja, 1986, f.31.

konselacion ngjyrash, interesimesh, harmonie lëvizëse, të cilat është vështirë t'i vendosësh në një hapësirë të caktuar kohore. Vizuelisht, krijohet mundësia të ndërtohet edhe një diagram gjeometrik për të kapur ritmin e kësaj valleje poetike. Pasi poezia nuk i duron vijat, do të hetohet raporti, ose vetëm paralelet: Qiell-Dhe, Yll-Vashë dhe Vdekje-Përjetësi. Qenësia e parë që hetohet është interesimi. I dyti, rënia dhe ngritja, apo rruga e tyre në përjetësimin artistik të këtij interesimi. Nëse për një moment abstraktohen titujt e cikleve (edhe të poezive), sheshon çështja e natyrës së këngës, po edhe tabani ku është vendosur interesimi krijues. Kjo është një vendosje vertikale, në kuptimin e gjallërimit poetik, apo më mirë në krijimin e kuptimit imagjinativ, që sipas normave të logjikës, mbështetësin kryesor duhet ta ketë nën këmbë. Atëherë, nëse së pari duhet të preket Dheri, për t'u arritur Qielli, kapet më lehtë edhe simbolika e Yllit, po edhe nuancimet kuptimore të emërimit Vashë. Nga këndeje, qartësohet edhe problemi i fundit Përjetësia. Më tutje, kjo përjetësi, e gjallëruar në Dhe dhe mbi Dhe ("Vallja e dherit"), vetëm atëherë krijon mundësinë e një harmonie lëvizjesh, ngjashëm me të yjeve. Pra, nëse përjetësia ka raporte koekzistimi me Dherin, atëherë edhe logjika e artit i duron raportet: Qiell-Dhe, Yll-Vashë, Vdekje-Përjetësi.²⁴

Në këtë kontekst, mund të thuhet, se edhe poezitë e një interesimi kozmogonik, edhe ato të një ritmi e muzike popullore, ndjenja që i përshkon ka ngrohtësinë e "dherit", kurse imazhet shprehëse, janë po të jetës, mbase edhe imagjinative, të njeriut. Të sjellim dy shembuj, fare të skajshëm për nga interesimi krijues, si dëshmi të një koekzistimi, domosdo relevant, të këtyre raporteve:

Marr të rëndët që përdhë.

Marr të fellët nën dhë.

Po që Lart prej Qënies vetë

Marr e jap përjetësi.²⁵

Vargu i katërt korrespondon, edhe kuptimisht, së pari me vargun e parë e të dytë, kurse pastaj me të tretin. Dihet, simbolistët përherë janë kujdesur për funksionin shprehës të fjalës, për rëndësinë kuptimore, për lëvizjen poetike, për hapësirën e fjalës.

Shembulli i dytë:

Sesì ndritesh përsëri!

²⁴ Moikom Zeqo, "Të dhëna të reja për Lasgush Poradecin". Bashkimi Tiranë, 1991, f.80.

²⁵ Lasgush Poradeci, "Vallja e yjve", Konstancë, 1933, f. 93

Sesì ndizesh përsëpari!

Sesì djek me dashuri

*Posi yll margaritari!...*²⁶

Veta e rrëfimit poetik në të cilën “ndizet”, “ndritet” dhe “digjet” (ylli) krijon mundësinë e kapjes së përkatësisë kuptimore të përemrit, që te Noli është quajtur përemër etik. Atëherë, nëse etniteti kërkohet në një taban konkret, edhe vizuelisht të kapshëm, “Dheri” duhet të jetë trolli ku “hiqet” kjo valle, laryshish të ndryshme poetike: herë e ngrysur e preokupative “Vallja e përjetësisë”, herë e hapur, plotë dritë e efekte “Vallja e luleve”, herë në varg të pashkëputur, për të krijuar “dritë nëpër terr të hapësirës”²⁷ “Vallja e yjve”.

2.3. Format poetike-klasike

Lasgush Poradeci në poezinë e tij gjakon formën e përkryer dhe madje-madje e arrin atë, në këtë rast, nuk mbetet vetëm poezi e formës, ngase ajo nga aspekti i tematikës ofron një reflektim interesant filozofik mbi jetën dhe vdekjen, mbi përqafimin e tyre të përhershëm.²⁸

Ai s’u largua nga bota e poezisë, për ta shndërruar atë në besim personal, fizik, metafizik. Besimin e tij poezinë, shihte si frymë të vetmisë esenciale njerëzore dhe jashtë doktrinave që dalin nga efektet e saj. Këtu përballemi me poezinë si ideal i përjetshëm, si frymë që është e kohës reale dhe përjetësisë, si ikonë përmallimi, si në kohë gëzimi, si në kohë trazimi. Po themi këtë, sepse nominimet e dhëna për poezinë nisen që nga lidhja me vendet e kulturës së lashtë hindase, pastaj shpeshherë përmenden edhe doktrinën panteiste, simboliste, romantike, paramoderne etj. Si rryma mund të jenë të aplikueshme në planin operativ, mirëpo poezia e Lasgushit nuk besojmë që i duron këto ndërhyrje. Ajo duhet të shihet si formë specifike e lidhur ngushtë me unin dhe zërin e autorit që ka besuar në poezinë pa doktrinën e saj. Këtu nuk ka misticizëm. Poezia ekziston jashtë shkrimit por manifestohet e thuret me shkrim, prandaj Lasgush Poradeci i beson fizikës që e thurë si formë, por edhe metafizikës së poezisë, të cilën e jeton me llafatarinë e vet. Poezia e Lasgushit jeton në botën e idiomës poetike, e cila meqë ka mbërritur ta asimilojë traditën, nuk e lodh fort kokën për të, aq më tepër për angazhimin e saj. Fundja nuk është i vetmi shembull në historinë letrare kur poeti dëshiron të mbetet asocial. Duke i besuar deri-duku sistemit poetik, por më shumë figurës së poezisë së

²⁶ Lasgush Poradeci, “Ylli i zemrës”, Prishtinë, 1990, f. 94

²⁷ Lasgush Poradeci, “Ylli i zemrës”, Prishtinë, 1990, f. 94

²⁸ Nysret Krasniqi, “Autori në letërsi”, AIKD. Prishtinë, 2009, f. 55.

Lasgushit. Mund të theksojmë se thuajse asnjë poezi, madje as poemat, nuk mund të analizohen, interpretohen e pse jo të shijohen estetikisht pa tendencën e një forme të interpretimit, e cila si dëshirë të veten e ka hetimin apo zbulimin e autorit të tyre.

Poezi et coetra... të Lasgush Poradecit, Shënime letrare të Mitrush Kutelit, Metafora e Lasushit – Sabri Hamiti. E para është letër filozofike-estetike dërguar Kutelit, e dyta është analizë formale e Kutelit studiues për poezitë e mikut poet, ndërsa e treta është analizë e infinitit të metaforës së Lasgushit nga Sabri Hamiti. E para tregon relacionin e autorit me krijuesen e vet (Poezi et coetra), ku Lasgushi thekson bindjen të cilës i rri besnike deri në fund, se kur eruditët e romantizmit dhe të izmave të tjera s'kanë mundur të kuptojnë esencën e vërtetë të poezisë. Kështu që forma (eidiosi) i poezisë së Lasgushit është tema e dashurisë, e dashuria është përjetësia. Kësaj forme e cila del si jo origjinale, por e thurur nga trupa të huaj, Lasgushi ia shton shpirtin (soma), pra forma për Lasgushin është amalagami i fizikës dhe i metafizikës. Ja si e sheh lidhjen e autorit me veprën e vet në kuptimin filozofik-estetik, Lasgush Poradeci: *Asnjë nga gjithë veprat artistike me jetë përbotshme, s'është origjinale; trupi i tyre është i huaj; vetëm shpirtin s'ua merr dot njeri.*

Kategorizimi trup i tyre por që nënkupton se forma e tyre janë vorbull e reciklimeve nëpër kohë e hapësirë, dhe si e tillë është kategori e korpusit, trupit, filozofisë materialiste, ndërsa shpirti prapë e kapërcen lidhjen e fortë, për të kapërcyer në metaforën e poezisë së tij. Prandaj nëse formës së poezisë së Lasgushit nuk ia atribuojnë shpirtin, rrezikojmë të ikim nga fryma e poezisë së tij, pra nga intenca e tij e shprehur në vargun: që nga bota njerëzore, ku këndoj me shpirtin plotë.²⁹

Prit-e prit! se po t'afrohet Zog' i Qiejve, O zot.

Këtë filozofi të bashkëdyzimit të formës poetike me shpirtin e heton bashkëkohaniku i tij Mitrush Kuteli, i cili duke e pasur të qartë njohjen empirike, por edhe shenjat e një dieje për format letrare. Nëse Lasgushi, me gjithë kërkimin e rreptë të formës, e favorizonte shpirtin, përjetësinë, kaosin e kozmosin, të cilin e pandehte si frymë poetike, Mitrush Kuteli e sfidon arbitrarisht këtë esencialitet duke thënë: në hierarkinë e elementeve që përbëjnë vlerën e një vepre poetike, forma ose trajta zë vendin e parë. Kuptimi ose përmbajtja nuk vinë përveçse në radhën e dytë. Prandaj, te Lasgushi kemi joarbitraritetin forma, por shpirt-përjetësie, gjithnjë si metaforë e vazhdueshme. Nuk mund të kalohet kjo dhembje poetike me fjalët se e gjitha

²⁹ Mensur Raifi, "Lasgushi, Noli, Migjeni", Rilindja, 1986, 33.

buron nga forma, sepse kundërpesha e shpirtit lasgushian e bën pyetjen nga forma: Çka i duhet forma, shpirtit të cilin e tumirë përjetësisht Lasgush Poradeci. Prandaj mund të theksojmë se lidhja e autorin me poezinë e vet më shumë bëhet nëpërmjet “segmentit” shpirt-formë dhe anasjelltas, sesa nëpërmjet segmentit dihotomik formë-përmbajtje sepse as përmbajtja, as kuptimi nuk e motivojnë sa duhet shpirtin e poezisë së Lasfushit.³⁰

Poezia e Lasgushit nuk është aq mimetike sa të jetojë aq ngushtë me formën siç pretendon Mitrush Kuteli. Ndërsa Sabri Hamiti dijetari modern mendon kështu: sa i përket poezisë së Lasgushit: Paradoksi ngjet se sistemi i Lasgushit nuk është u mbyllur, ai mbetet i hapur, qoftë edhe me kusht që ky sistem të ketë qenë i projektuar, por jo edhe i përfunduar. Kjo sugjeron diferencialitetin në vend të “zingjirit poetik”. Paradoksi i poezisë së Lasgushit e sfidon dukshëm sistemin e projektuar apo të paprojektuar poetik, në favor të shpirtit poetik (metaforës) ku gjendja ndërmjet poezisë dhe filozofisë mbetet e hapur.

Te *Vallja e Qiellit*, që është emërtim relativ i një pjese të poezisë “udhëheq” metafora e lojës, këngës dhe dëfrimit metafizikë, që jeton jashtë konceptcionit njerëzor. Pra, ndërmjet formës poetike ecën në drejtim të asaj që e përbën frymën jetësore, kozmologjike, thjesht mendimin metafizik të njeriut, i cili më pastaj shndërrohet e merr formën poetike artistike. Kjo tumirë edhe njëherë të dhënë se forma te Lasgushi është në funksion të eidos-it (metafizikës).

2.4. Format klasike: Oda, Himni

Lasgush Poradeci është poet lirik, që e karakterizon në rend të parë lirizmi i thellë, subjektiviteti dhe një dashuri e madhe kundrejt temave e motiveve të cilat i lëvron në poezinë e tij. Oda me titullin “Shpirtit” është lirikë që shquhet për thellësinë filozofike dhe pasurinë semantike. Poradeci shpirtin e koncepton si frymë të përjetshme që buron nga qenia absolute, por që më tej konkretizohet duke frymëzuar një ëndërrim të pafaj:

*Fatum, o Shpirt, ti je nër gaze,
Dhe nër mjerime ja fatlum³¹*

Dashuria e madhe e poetit ndaj zonjës shqiptare-Shqipërisë, djalërisë dhe simboleve nacionale shprehet me një lirizëm të hollë në himnin kombëtar, “Marshi i djalërisë”.

³⁰ Nysret Krasniqi, “Autori në letërsi”, AIKD. Prishtinë, 2009, f. 56.

³¹ Lasgush Poradeci, “Ylli i zemrës”. Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 12.

Edhe këtë lirikë himnizuese, si mbarë poezinë e Lasgushit, e karakterizon ndërfitja e elementeve të universit poetik të tij, si ylli, zjarri etj...

*Urdhëroj i Madhi Zot:
Zu ndrin yll' i Shqipërisë;
Ndrin e mës' përmbahet dot,
Se që sot e jetë-plot
Po rreth zëmr'e Djalërsië³²*

Nëse titullin e marrim ashtu siç merret zakonshëm, si ikonë të saj që “përvijohet” në “tekst”, atëherë del se odeja i kushtohet shpirtit si universalitet, si dashuri universale, si përkushtim e lutje nga i cili buron fryma e Zotit, përjetësia, qenësia sovrane e tij, përplasjet dialektike jetësore *gas e helm*. Lasgushi i beson ekzistencës së shpirtit, nga e cila buron edhe ekzistenca njerëzore, e cila është gjithnjë relativitet. Kjo strofë metaforizon botëkuptimin intencional autorial për shpirtin nga pozita e një të *tashmeje hipotetike* (koha e autorit), pra, si një faktum metafizik imanent, si një metafizikë imanente e përballjes me ekzistencën e tij. Strofa shndërrohet në diskurs metaforik për ekzistencën e tij të pakohë por të rrojtur nga një kohë reale, bile edhe e imagjinuar qoftë kjo. Strofa rri në nivelin metafizik të referencës. Ndërsa strofa e dytë metaforikisht s’forcon funksionin kozmologjik të shpirtit në raport me botën, intencionalisht botën e autorit, por edhe botën si universalitet.³³

*Ti botës s’onë – I prure lajmin
E nj’ ëndërrim të pafaj:
Për mallin t’ënd më të pastajmin
Ti kuvendon që përmi botë,
Dhe në gëzim i bije lotë,
I bijë gas në zë të saj*

Në këtë komunikim metafizik hetojmë “funksionin” e shpirtit në krijimin e rrozullimit nga prizmi autorial sepse konform zhandrit, subjekti poetik ruan integralitetin e këtij komunikimi. Edhe strofa e tretë e kësaj poezie që shenjon ndërlidhjen e individit me shpirtin si universalitet, e për ne ky është subjekt poetik alias autori empirik, me fuqinë, zemrën si materialitet të shpirtit dhe harmoninë që sublimon ai për vdekjen e ekzistencës.

³² Lasugh Poradeci, “Ylli i zemrës”. Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 43.

³³ Nysret Krasniqi, “Autori në letërsi”, AIKD. Prishtinë, 2009, f. 60.

*Kur del mi male yll'i dritës
E shuhet nata prap ti,
Ti me vështrimin vetëtites
C këlqen në fund të zemrës s'ime
Dh'i bën prej këngës së një grume
Një të përjetshme-harmoni.*

Pra, harmonia e njeriut vjen si pasojë e shkëlqimit të shpirtit dhe se komunikimi me shpirtin është nevojë e po kësaj ndërlidhje të njeriut (produktit të tij) me krijesën e vet (individi).³⁴

Prandaj autori ynë komunikimin e parë poetik, do të thoshim parësorin, e lidh në sfera të menduara metafizike, ku forma poetike mbetet vetëm realizim i këtij mendimi. Kjo nuk është mbyllje, por hapje ndaj metafizikës nëpërmjet metaforës.

Në fund është e rëndësishme të theksohet që poezia e Poradecit për nga forma është realizuar në mënyrë të përsosur, atë e karakterizon një harmoni e mendimit me rimë, ritëm, me një zgjedhje metrike të veçantë të menduar mirë. Nga ana formale poezitë e tij përbëhen zakonisht nga strofa katërshe (katerna) me vargje shtatërrokëshe, tetërrokëshe dhe të tjerë, ndërsa rimat janë të alternuara.³⁵

2.5. Lëvizja poetike dhe stili

Lëvizja poetike e krijimeve të Lasgush Poradecit është një ndër më të arriturat në poezinë tonë, mundëson zënien e tharmit të poetikës, që ndërtohet mbi parimin krijues të një origjinaliteti fascionues në mbarë poezinë tonë të Rilindjes Kombëtare. Nëse mendohet se stili është vetë krijuesi, atëherë poezia e Lasgushit është më karakteristikja në mbarë poezinë tonë të Rilindjes. Kjo është një nga kërkesat të bërjes art poetik: origjinaliteti. Është e tillë për dy arsye themelore: e para, është vetvetja dhe e dyta rrafshi i realitetit mbi të cilin është ngritur. Ndodh kështu sepse veçohet bota e brendshme e poetit, që është përbërësi bazë i realizimit artistik të poezisë së tij dhe më i fuqishmi në poezinë tonë. Poezia e Lasgushit është kthim i sërishëm në realitetin e kohës, por një kthim krejt tjetër nga ai që e takojmë në poezinë e Rilindjes sonë Kombëtare. Ajo i kthehet realitetit përmes lëvizjes poetike, përmes mallit dhe kthehet përmes valles së yjeve. Nuk mund të thuhet se poezia e tij është një ikje

³⁴ Nysret Krasniqi, "Autori në letërsi", AIKD. Prishtinë, 2009, f. 61.

³⁵ Moikom Zeqo, "Të dhëna të reja për Lasgush Poradecin". Bashkimi Tiranë, 1991, f.95.

nga realiteti, ngase përmasën e kohës e ka të plotë, por as nuk mund të thuhet se ajo është ikje.³⁶

Ka shumë arsye që e shmangin këtë mendim. Së pari, poeti ka mjaft poezi, në të cilat ka ngritur në art disa nga nyjat e gjëllimit të njeriut tonë nëpër kohë. Poezitë për Naim Frashërin, për gjuhën, për Poradecin, poema “Mbi ata”, këngët për natyrën që është shumë shqiptare. Poezia e tij ka një vendosje të denjë poetike mbi një bazë kohore të caktuar mirë, por që në artin e tyre kapërcejnë ata kufij dhe bëhet pjesë e udhës së ekzistimit tonë shpirtëror. Së dyti, edhe krijimet e tij ku mbretërojnë motive kozmogonike, realizohen të plota vetëm me imazhet shprehëse të natyrës, tokës. Së treti, dashuria e trimit dhe e vashës së tij poetike është e gjitha një përtrirje malli për ato që ikin e nuk kthehen.

Poezia e Lasgushit ka mbështetje të tërësishme me natyrën e fëmijërisë së tij, andaj edhe është aq e ngrohtë, aq e ndjeshme, gati femërore me subtilitetin e saj, dhe aq njerëzore. Kërkimi i mjeteve shprehëse, këmbëngulja e gjetjes së simbolit dhe figurës përkatëse, për ta shprehur një imazh poetik, durimi dhe pritja, thadrimin e idesë poetike, për formësimin e saj, kërkimi i frymëzimit edhe në shenjat e akretimeve dhe të gjuhës së miteve janë disa nga karakteristikat që i hasim edhe në poezinë e Lasgushit.³⁷

Pjesa më e madhe e motivimeve dhe e temave që ka marrë për brumë të poezive të tij, janë universale.³⁸

Ato janë sa të tjerëve aq edhe të Lasgushit. Motivin e sakrificës nuk e gjejmë vetëm tek popujt, ku historia ka vënë në alternativ ekzistimin e njeriut, por edhe te popujt që kanë vuajtur peshën e historisë, robërinë.³⁹

Pelikani i Lamartinit është një sakrificë por edhe i një mjedisi të caktuar. Kurse Nositi i Lasgushit, për trajtimin poetik të këtij motivi, është domosdo edhe historike që kishte kushtëzuar koha e tij. Vjershat për natyrën, për liqenin dhe kroin, herë e kapërcejnë realitetin, i kapërcejnë edhe përmasat e hapësirës, por nuk ndahen prej kohës së tij, kryesisht me idenë, herë nguliten thellë në truallin e akretimeve të kujtimeve të poetit me imazhet dhe strukturën e tyre poetike.

³⁶ Emin Kabashi, Lasgush Poradeci: Jeta dhe vepra. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1997, f. 179.

³⁷ Emin Kabashi, Lasgush Poradeci: Jeta dhe vepra. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1997, f. 181.

³⁸ Mensur Raifi, “Lasgushi, Noli, Migjeni”, Rilindja, 1986, f. 44.

³⁹ Emin Kabashi, Lasgush Poradeci: Jeta dhe vepra. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1997, f. 183,

Vjershat që i shtrohen parimit të valles së yjeve, përveç rregull i ligjësisive kozmogonike, janë shenja të brendësisë së çështjes nga pluhuri kozmik i kujtimeve të fëmijërisë së tij. Kurse motivi i dashurisë, të gjitha herë i kapërcen caqet e rrymimeve letrare dhe filozofike për të cilat bëhet fjalë. Është më shumë romantik, edhe platonik dhe vizionar më shumë se ç'jemi mësuar të hasim në poezinë e Rilindjes. Aty është i pranishëm edhe panteizimi naimian, por fakti se përbërësit e strukturës së këngës popullore janë tejet të pranishëm përcaktojnë qenësinë e poezisë së tij dhe poetikës së kësaj poezie. Krijimi imagjinar nuk mund të qëndrojë pa elementin kohë, nuk realizohet pa përmasën e saj. Në këtë mënyrë poezia e Lasgushit, në radhë të parë është bijë e momentit të caktuar shoqëror dhe e nivelit të caktuar kohor, të mjedisit të caktuar shoqëror dhe e nivelit të caktuar të zhvillimit të letërsisë shqiptare në përgjithësi. Lasgushi kishte botëkuptimin e tij ndaj artit të fjalës, e kjo ka kushtëzuar që ai të bëhet ndonjëherë edhe pa fajin e tij, rob i kërkimit të frymëzimit dhe i përpunimit të varianteve të ndryshme që lëvizte në anën krijuese të poetit.

Mund të hetohet se Lasgushi, në disa nga vjershat e tij më të frymëzuara që ka pasur, por jo në të gjitha, sikur e ka përdorur më pak foljen, për të krijuar lëvizjen poetike, nuk ka gdhendur vargun, gjë që dëshmon që ka pasur një periudhë në krijimtarinë e tij, kur frymëzimi nuk është kultivuar deri në përsosje. Në poezitë e këtilla, harmonia poetike nuk e ka përkryerjen që e takojmë te shumica e poezive të tij, por ngrohtësia emocionale është më e madhe.⁴⁰

2.6. Figurat elementare

Pasthirrmat – janë shprehësia poetike e Lasgushit, disa pasthirrma që ndeshen, qoftë të përdorura më shpesh, qoftë të funksionalizuara më mirë në gjuhën dhe stilin poetik të Lasgushit, janë **ah**, **o**, **ububu**, **obobo**. Pasthirrma **ah** dhe **o** hasen më dendur krahasuar me pasthirrmat e tjera. Ato janë një mjet i preferuar i Lasgushit dhe, si të tilla, i shërbejnë për ta sforcuar shprehësinë e tij poetike. Pasthirrmat **ah** dhe **o** mund të shprehin dhembje, pikëllim, dëshpërim në një rast, ndërsa në rastin tjetër ato mund të jenë mjete përmes të cilave shprehet habia ose frika.

Pasthirrma **ah**, ta zëmë te poezia “Vdekja e Nositit”:

⁴⁰ Moikom Zeqo, “Të dhëna të reja për Lasgush Poradecin”. Bashkimi Tiranë, 1991, f.34.

Pa nis ah! Gjirin ta godas...
Dh'e hap ah! gjirin më një cas...,
Dh'e nginj ah! Zoqtë e vdes me gas!...⁴¹

Siç mund të vërehet ngarkesa emocionale që shkrihet në këtë tërcet, e dhënë e sforcuar në saje të pasthirmës, nuk ka të bëjë veçmas as me hidhërimin, as me habinë dhe as gëzimin, më parë do të thoshim është një dhembje që kënaqë, një dhembje krenare e aktit të qëllimshëm të flijuesit.⁴²

Pasthirmja o gjithashtu është një nga përbërësit e rëndësishëm stilistik e gjuhësor të poezisë së Lasgushit. Kryesisht i ka shërbyer në ato vargje ku shprehet dashuria për vashën, si bie fjala: “O vashë e të rriturit t’im”, “O pëllumbeshë” e shpirtit t’im”, por edhe për ta sforcuar shprehshmërinë e një adhurimi të pamasë për këngën pleqërishte, për gjuhën e zjarrtë, për Zotin, për universin etj.

Kjo pasthirmë më së miri ka dalë e funksionalizuar te poezia “Kënga pleqërishte”:

O këngë pleqërishte! O vjershë’e Vëndit t’em!
O fjalë që më dhimbsesh, e që më bën ujem!
O mall! O psherëtimë! O vajë! O lot i zi!
O shpirt i përvëluar që qan nër syt e mi!

Përsëritjet dhe shkallshmëria e përdorimit të pasthirmës o, përveç që ofrojnë shpërthimin e ndjenjave të autorit, në të njëjtën kohë i japin një ritëm karakteristik poezisë. Në këtë aspekt, dhe nëse është konstatuar se vetëdija poetike e Lasgushit nuk ka lejuar që mjetin shprehës ta përdor vetëm si stoli rasti, mund të thuhet se vlera etnike e o-së është e pamohueshme. Sidoqoftë është e padiskutueshme që o-ja përpos që i shton afektivitetin dhe shprehshmërinë e poezisë, në këtë kontekst merr edhe vlera të caktuara komunikuese. Ajo natyrshëm kalon nga funksioni i fjalës që potencon, që thekson dicka, në një fjalë që kumton, në një fjalë pa të cilën komunikimi nuk do të mund të paramendohej si i plotë

Lasgushi përdor edhe pasthirmja që shprehin një disponim më të ngrysur: brengën, keqardhjen, dhembjen, shqetësimin, habinë a vuajtjen. Pasthirmja ububu në mënyrë tipike është te krijimi:

⁴¹ Lasgush Poradeci, “Vallja e yjve”, Konstancë, 1933, f. 105.

⁴² Hysen Matoshi, “Stilet në letërsinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore”, Prishtinë, 2009, f. 70.

*Ç'u nxinë mallet, ç'u nxinë,
Gur' i kuq lëshon mavinë:
Qani, djem, e mbani zinë!
Qani gjithë Shqipërinë,
Toskërinë, Gegërinë-
Ububu! Ç'humbi lirinë⁴³*

Pra, siç mund të shihet, poeti përmes pasthirmës ububu shpreh brengën e tij për fatin e Shqipërisë e përkatësisht të Vlorës që mbahej e pushtuar.

2.6.1. Figurat stilistike

Ndër figurat stilistike në poezinë e Lasgushit, vendin kryesor e zënë figurat gjuhësore sado që edhe tropet janë të pranishme.⁴⁴ Poezia e Lasgushit përbën shembullin tipik të intesifikimit të realizuar në trajta të ndryshme të përsëritjes. Intesifikimi në trajtë të përsëritjes, si komponent stilistik ndër më të rëndësishmit të poezisë së Lasgushit, denduria e përdorimit e bën funksionalizimin artistik të mjeshtrit tonë të madh të poezisë.

Forma më e shpeshtë e përsëritjes në vargjet e poetit tonë të madh është në funksion të realizimit të rimës, më rrallë të asonancës dhe fare rrallë kjo përsëritje realizohet përmes figurës së aliteracionit.

Asonanca – në poezinë e Lasgushit është tepër e rrallë dhe si e tillë nuk përbën një element identifikues të stilit të tij sa herë që mbështetemi te koncepti teorik për asonancën si rimë e paplotë. Janë të rralla rastet kur përdor asonancën në vargëzim.

Lasgushi e shmang asonancën për t'i hapur udhë rimës, madje edhe duke e zhvendosur në mënyrë të panatyrshme theksin e fjalës. Për shembull fjalën paraoksite **pluhur** e shndërron në fjalë oksitone **pluhur** ta ruajnë strukturën e caktuar të rimës.

Lasgush Poradeci si njohës i mirë i teknikave të krijimit, me sukses e funksionalizon aliteracionin në disa nga krijimet e tij më të mira, si fjala bie, te poezia “Naim Frashërit”

⁴³ Lasgush Poradeci, “Ylli i zemrës”. Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 24.

⁴⁴ Hysen Matoshi, “Stilet në letërsinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore”, Prishtinë, 2009, f. 73.

Lasgushi përmes bashkëtingëllores **v** tashmë në një fushë tjetër tematike atë të dashurisë, ka ofruar edhe një shembull të përkryer të aliteracionit:

Venitu, vashë, venitu

Përsëritjet – në poezinë e Lasgushit dhe veçmas përsëritjet e tingujve si njësi më të vogla brenda vargut nuk janë të rëndësishme vetëm në aspektin e përcaktimit të euforisë në veprën e tij, ngase ato janë bërë një element identifikues edhe për stilin e tij përgjithësisht. Shprehësia poetike dhe aspektet kumbuese, të realizuara në saje të përsëritjes së tingujve dhe rrokjeve, përveç vlerës identifikuese që i japin poezisë së Lasgushit, njëkohësisht janë një nga përbërësit më të realizuar artistik në veprën e tij.

Përveçse përsërit tingujt e rrokjet në funksione nga më të ndryshmet, Lasgushi përsëritjen e shtrin edhe në njësitë leksikore, pra në fjalët dhe madje edhe në grupet e fjalëve. Këto përsëritje janë mjaft të shpeshta dhe ndeshen në pozita të ndryshme në krijimin e tij. Në teorinë e përsëritjes është i njohur edhe paralelizmi sintaksor, d.m.th. rasti kur përsëriten fjalët e vargut, por përsëritet tërësisht struktura morfologjike dhe sintaksore e tij.⁴⁶

Refreni – po kështu, është ndër format më të pranishme të përsëritjes në përmbledhjet “Vallja e yjeve” dhe “Ylli i zemrës”. Refreni del zakonisht në vargun e fundit të strofës siç e gjejmë tek poezia “*Kur m’u rite vogëlushe*”:

Kur m’u rite vogëlushe,

Vogëlo si flutura

Mes-hollë-këputura.

Të pash më sbukuroshe,

Bukuro si flutura

Mes-hol-këputura.

Anafora – figurë mbretëreshë e përsëritjes në poezinë e Lasgushit, përveçse haset dendur dhe zotëron mbi të gjitha figurat, jo rrallë ndeshet e mpleksur edhe me figurat të tjera, me çka

⁴⁵ Lasgush Poradeci, “Vallja e yjeve”, Konstancë, 1933, f. 29.

⁴⁶ Hysen Matoshi, “Stilet në letërsinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore”, Prishtinë, 2009, f. 94.

poeti synon që në rend të parë, ta sforcojë afektivitetin gjuhësor të krijimit, por në raste të caktuara një gjë e tillë do t'i shërbejë edhe si mjet për ta arritur harmoninë.

Shembull poezia “Malli”:

*Syri-i bukur që t'u mvret-
Syri-i që më lëndon
Do më lerë-a von a shpejt,
Do më lerë-a shpejt a von,
Do më lërë-a vonë a shpejt,
Do më lerë-a shpejt a von,
Syri-i bukur që t'u mvrejt-
Syri yt që më lëndon.⁴⁷*

Paralelizmat – në poezinë e Lasgushit dalin në funksion të krijimit të simetrisë së formave. Shembullin më të mirë të realizimit të paralelizmit e gjejmë në krijimin “**Të kërkova me qiri**” (Këngë):

*Tëk kërkova me qiri,
Flokë-ndritura me qiri,
Flokë-ndritura-flori,*

Poeti përdor një paralelizëm në ndërtimin e gjithëmbarshtëm të krijimit. Përmes simetrisë së strofave.

Trioleti⁴⁸ – megjithëse ka krijuar një numër trioletash, për ta qartësuar më mirë strukturën e tij dhe vlerat letrare që i ka te Lasgushi, sjellim krijimin tretriletësh “Ah me atë mall që më ke ti”:

*Ah me-atë mall që më ke ti,
Moj zemërzën m'a more:
Gëzon e quan në fshehtësi,
Ah me –atë mall që më ke ti.*

Rondeli – Lasgushi e pasuron poezinë shqipe me forma të cilat deri atëherë ishin të panjohura në kulturën tonë letrare. Forma më e shpeshtë e rondelit është trembëdhjetëvargëshi.

⁴⁷ Lasugh Poradeci, “Ylli i zemrës”. Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 83.

⁴⁸ Hysen Matoshi, “Stilet në letërsinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore”, Prishtinë, 2009, f. 117.

Pavarësisht nga numri i vargjeve rondeli realizohet mbi përsëritjen e dy rimave. **“Përqaqimi”** rondeli i Lasgushit nga përmbledhja “Ylli i zemrës”, reazohet me këtë skemë përsëritjesh me rimash: *ABab abAB ababA*.

*Jetë-e-vdekje-përqaquar,
Nuku di se ku po vete:
Shkon e ndal e ri menduar
Në kalove-edhe në mb*

Epifora – Lasgushi e ka përdorur në numër shumë të vogël, pikërisht në krijimet me temë të atdhedashurisë, pra në ato poezi ku përpiqet që zëri i tij të bëhet më kumbues, rrjedhimisht më ndikues që e gjejmë tek krijimi “Ç’u mbush mali” (Rapsodi popullore) që është një himn për luftëtarët çlirimtarë të Vlorës:

*Seç u mbush e shkreta Vlorë
Plot me krushqë eme dasmorë:
S’janë krushq edhe dasmorë,*

Pa dyshim se përsëritja epiforike e fjalës dasmorë bëhet me qëllim të përqendrimit të vëmendjes së lexuesit te protagonistët e këtij krijimi duke përdorur edhe gradacionin si një mjet përmes të cilit përforcon shprehësinë.⁴⁹

Një lloj mjaft i shpeshtë i përsëritjes në poezinë e Lasgush Poradecit është edhe ai që realizohet nëpërmjet figurës së andiplazmës. Përsëritjet e fjalëve të grupit të fjalëve nga fundi i vargut paraprak në fillim të vargut vijues ndeshen dendur në poezinë e tijdhe si të tilla, i japin asaj një ritëm të veçantë, siç e gjejmë te poezia “Ndjenja dhe njeriu”:

*Gjithë të ndjell një mall i ri!
Mall i ri, -haj! Mall i zi...
Po njeriu ndaj dëgjonte,
Hapte gojë –e kuvendonte-
Kuvendonte me ta qarë,
Sapo Zoti më dha jetë:
Më dha jetë e më la vetë...⁵⁰*

⁴⁹ Hysen Matoshi, “Stilet në letërsinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore”, Prishtinë, 2009, f. 120.

⁵⁰ Lasgush Poradeci, “Ylli i zemrës”. Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 24.

Tropet – njëra nga vlerat dalluese të poezisë së Lasgushit ka të bëjë pikërisht me harmoninë. Harmonia për një vepër letrare, e cila si e tillë është bashkimi i pjesëve në një tërësi unike, është jashtëzakonisht e rëndësishme, jo vetëm si mënyrë e bashkimit të përpjestueshëm, por edhe si mënyrë funksionimi nëpërmjet përbërësve. Simbolet, epitetet, krahasimet, metaforat e tij janë qëllimi i vetëvetës, ato janë mjete shprehëse që i shërbejnë autorit për ta poetizuar idenë dhe për ta fuqizuar artistikisht shprehjen e tij poetike.

Epitetet – Ndër mënyrat më të shpeshta të realizimit të epitetit në poezinë e Lasgushit është ajo që gjen mbështetjen te përdorimi i mbiemrave të nyjshëm. Gjatë cilësimit të subjekteve të tij lirike, të ideve, apo të peizazhit etj. Ai përdor epitete të këtilla të sajara nga mbiemrat të nyjshëm si: *Këngë-e pakënduar, këngë; e pakuptuar, vaj –i-pavajtuar*.

Lasgushi është mjeshtër i epiteve dhe këtë e manifeston, vec përmes përdorimit të epiteve të llojllojshme, edhe në saje të mjeshtërisë që një epitet ta përdor për t'i cilësuar dy emra. Bie fjala te “Vallja e luleve”, që e zëmë ngojë më parë, ai ofron shembullin më të mirë të një cilësimi kaq të rrallë:

Vijnë vashat valle-valle

Gjushë –e-gji-stolisur

Krahasimet – Lasgush Poradeci në veprat e tij poetike ndër tropet më të shpeshta përdor edhe krahasimin. Krahasimet në veprën e tij i gjejmë kryesisht në krijimet me tematikë erotike dhe ato janë në funksion të pikasjes së bukurisë së vashës, e cila jo rrallë vihet në kontekst përqasjes së bukurisë që e ka krijuar natyra vetë:

Cipëzën e bardhë, cipëzën e kuqe,

Gushën si zëmbaku, buzët si burbuqe.⁵¹

Në krahasimet e Lasgushit, të cilat realizohen në krijimet me tematikë erotike, objekti i krahasimit qoftë edhe brenda një krijimi ndryshon, kështu, te “Kroji i fshatit tonë” ai spikat bukurinë fizike të vashës përmes përqasjes me natyrën, me botën bimore: “Gushën si zëmbaku, buzët si burbuqe”. Pikërisht krahasimi i përbërësve të dy botëve të ndryshme përbën një aspekt dallues nëpërmjet krahasimit të rëndomtë të gjërave të së njëjtës kategori dhe krahasimit letrar.⁵²

⁵¹ Lasgush Poradeci, “Ylli i zemrës”. Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 37.

⁵² Moikom Zeqo, “Të dhëna të reja për Lasgush Poradecin”. Bashkimi Tiranë, 1991, f.88

Simbolet – Lasgushi është poet që përdor simbole në një numër të kufizuar poezish dhe veçmas në ciklin “Vallja e vdekjes”, “Vdekja e Nositit”, “Lundra dhe Flamuri” dhe “Gjeniu i Anijes”. Ky cikël krijimesh veçohet si kulm i krijimtarisë së tij, poezi që e identifikojnë Lasgushin si një krijues të madh andaj pikërisht këtu duhet kërkuar bazën e një interesimi kaq të shprehur për simbolin si figurë stilistike në krijimtarinë e tij. Simbolet e Lasgushit si: nositi, anija, lundra, gjeniu, flamuri, vallja, ylli, etj., krijojnë marrëdhënie të veçanta përfaqësimi, të cilat mund të deshifrohen vetëm po që se kundrohen në tërësinë e krijimit. Simbole të idealit, ato që i udhëheqin në jetë, që i drejtojnë.

Zvogëlimi – është tipar i poezisë së Lasgushit. është në përputhje me përmbajtjen e poezisë dhe me tonin poetik të tekstit që poeti e përdor, shembull: *zemër-zemërz*, *pasqyrë-pasqyrëz*, *shkronjë-shkronjëz* etj. Poeti këtë mjet e përdor dhe si stilizëm në poezinë që ia kushton Naim Frashërit, ku edhe hasim fjalë të përbashkëta tek të dy poetët, *mëmëdhen*, *këngëz*, *fjalëz*, *vashëz*, *shkronjëz*.

FIGURA KOZMIKE – Ëndërrimi kozmik në poezi shenjëzon përherë një bashkim, një lidhje e jo kurrë një përjashtim dhe një ndarje. Figura më e preferuar e poezisë, që do të jetë sa më e hapur në jashtësi, është *hapësira*, kjo është një mundësi dhe prespektivë e njeriut dhe e poetit, që t’i prishë kufijtë në mes të jetës dhe vdekjes, në mes të së shkuarës dhe të ardhmes.⁵³

Jetë-e-vdekje-përqaftuar

Nuku di se ku po vete

Këndon Lagush Poradeci në një poezi të vetën. Ëndërrimi poetik kërkon një hapësirë të lirë. Vetëm ëndërrimi poetik, kozmik, mund t’i kalojë të gjithë kufijtë. Ndërsa figura e parë e poetëve kozmikë ka qenë dhe mbetet *Ylli*. Për *Yllin* e Lasgushit nuk mund të flitet vetëm si për një simbol, në të përmblihet një kuptim mbi jetën, ndoshta edhe vetë botëkuptimi i poetit. Ylli i Lasgushit është i pranishëm edhe në poezitë që mbështeten në jetën tonë reale. Ylli, është i përmbajtur edhe në vetë dy titujt e veprave të këtij poeti: *Vallja e yjeve* dhe *Ylli i zemrës*. Poeti përmes valles së yllit në këtë poezi dhe funksionit të tij poetik dëshiron ta humanizojë kozmosin, hapësirën, njerëzimin. Kjo është një figurë poetike e humanizuar që zë “fill me dashuri”, “Plot me jetë-e mall të valë”. Do të thotë, fuqia e jetës, nga kjo poetikë, i detyrohet fuqisë së dashurisë.⁵⁴

⁵³ Sabri Hamiti, “Lasgushi Qindvjeçar”. Faik Konica, Prishtinë, 1999, f.13-14-15.

⁵⁴ Sami Krosi, “Filozofia e jetës në poezinë e Lasgush Poradecit”. Shkup, 1998, f.54

FIGURAT E MENDIMIT – janë një nga më të rëndësishmet të stilit poetik të Lasgushit. Përcaktimi për këto figura motivohet qoftë nga shpeshësia dhe funksionalizmi i tyre në strukturën e krijimit poetik të Lasgushit, qoftë nga vlerat dhe gjetjet origjinale që ofrojnë simbolet kundruall veprave të autorëve tonë të tjerë. Prania e figurave të mendimi në veprat poetike “Vallja e yjeve” dhe “Ylli i zemrës”, gjegjësisht funksionalizmi i tyre në këto përmbledhje është një pasqyrim i aspekteve të domethënies që e ofron bota e pasur filozofike e Lasgushit.⁵⁵

2.7. Fuqia e artit poetik lasgushian

Poezia për Lasgush Poradecin është produkt njerëzor i një bote ndryshe nga realja, natyrorja që shpreh një kumtim, shpresë, mbresë për botën që nuk i përkasin botës së brendshme në të cilën jemi flakur, kjo tregon se poezia për Lasgushin është nostalgji, kujtesë, ëndërr, mall, etje, varfëri, dashuri, llaftari, harmoni, përsosje. Për të gjitha këto poeti na bën me dije se poezia i takon intuitës, imagjinatës, moralit, frymëzimit, zemrës, shpirtit, dashurisë, dritës, përjetësisë. Poezia për poetin është dërgimtare mjaft e duruar që e pranojnë shpirtat e fuqishëm prometheik të cilët nga zemrat e tyre nxjerrin zjarr, nga zjarri dritë dhe nga drita përjetësi,⁵⁶ se vetëm këta janë shpëtimtarët e vizionuar dhe të harmonizuar. Pra, arti poetik në kuptimin e plotë të fjalës është cilësi, vlerë dhe dhuratë natyrore e shpirtërore. Poeti me të drejtë ka konstatuar se definicioni i artit është ligj shpirtërore hyjnor i cili përcaktohet nga frymëzimi që i dedikohet lumturisë së vërtetë njerëzore. “Prandaj misioni i artit është të na jep kënaqësi estetike që qëndron përmbi të gjitha këto mizerje të jetës. Këndojmë një poezi, shikojmë një pikturë, dëgjojmë një simfoni dhe kënaqemi! Jeta na ëmbëlsohet na bëhet e bukur...”⁵⁷ Kjo kënaqje nuk krijohet me anë të qasjes së intelektit, analizës, vëzhgimit dhe përvojës së jashtme, por diçka tjetër, është kredhje në brendinë e poetit, në fshehtësitë më të thella shpirtërore siç janë: shqetësimet, përjetimet, vuajtjet dhe aspak s’kanë të bëjnë me njohjen racionale. Poezia për poetin është ndërmjetësuese e përjetësisë duke ngadhënjyer fatin e njeriut me ndihmën e fjalës së bukur poetike. Tek universi poetik i Lasgush Poradecit hasim si te rrallëkush në poezinë shqipe një magji të pastër të gjuhës shqipe, të forcave magjike të tingujve, që japin thirrjet e jetës nëpërmjet fjalëve në radhitjen objektive njeriu, jeta, Zoti, përjetësia. Poezia e Lasgush Poradecit ka arritur një shkallë të lartë artistike. Vepra

⁵⁵ Hysen Matoshi, “Stilet në letërsinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore”, Prishtinë, 2009, f. 140

⁵⁶ Ilir Shyta, Bibliografi e autorizuar për jetën dhe veprën letrare të Lasgush Poradecit, f.33

⁵⁷ Ilir Shyta, Bibliografi e autorizuar për jetën dhe veprën letrare të Lasgush Poradecit, f.35

e tij i përket atyre veprave të cilave koha nuk ua zbehu dhe humbi rëndësinë dhe ua bënë të pranishme ekzistencën. Por vepra e tij nuk është shume jetëgjatë. “Poezia e Lasgush Poradecit është univers i tretur në fjali”.⁵⁸

Imagjinata e lindur dhe pasioni i ndezur u fuqizuan nga kultura e gjerë dhe arti popullor. Në poezinë lasgushiane fjala dhe shpirti i krahinës së tij fitoi një tingëllim e sensualitet të ri. Arti popullor nuk erdhi në poezinë e tij si material i përpunuar, por si një element strukturor i rëndësishëm. Poezia e tij nis tek tradita më e mirë popullore tek ajo e jugut dhe u ushqyer më pas tek poezia e Rilindjes sidomos ajo e Naimit. Kultura e gjerë, njohja e thellë e letërsisë evropiane, ia pasuroi shpirtin dhe imagjinatën, i përpunoi shpirtin dhe aftësinë për të shprehur bukur atë që e ndiente, por nuk e preku dot origjinalitetin dhe ngjyrën kombëtare të poezisë së tij. Veçoria më kryesore e poezisë lasgushiane është lirizmi, i cili nuk është thjesht shprehja poetike e një shpirti të butë, po e një shpirti të thellë, që është sa i ëmbël në adhurim aq i hidhur i egër i rreptë në urrejtje. Poezia e tij karakterizohet nga sinqeriteti, shpërthimi i ngrohtë dhe lakonizmi. Ndjenja e thellë poetike lidhet jo vetëm me gjendjen pasionante, por edhe me përshkrimet. Kur ai përshkruan ne nuk shikojmë, por ndjejmë se si gjërat e thjeshta, të imta, të pakapshme nga syri i njeriut të zakonshëm bëhen rrezatuese. Fjala në poezinë e Lasgushit ka një rëndësi të veçantë, në të harmonizohet mendimi me qetësinë e jashtme, tingulli me ritmin, heroi lirik i poezisë së tij është i ndërgjegjshëm për misionin fisnik që i ka vënë vetës, atë të sakrifikimit për ideale të larta. Ai ia doli që nëpërmjet muzikalitetit të vargut (aliteracionit, onomatopesë, rimave) të realizojë tiparet stilistike të estetikës simboliste. Fjalori i zgjedhur, përbërë nga fjalët e pasura shqipe i bën poezitë e tij të ndjehen sa më shqipe. Ai në poezinë e tij përdor fjalë që lidhen me dukuritë dhe jo me sendet, reflekton perceptimin dhe jo vëzhgimin apo prekjen e tyre, ai refuzon vendngjarjen dhe kohën e ndodhjes, duke krijuar shtirjen universale në poezinë e tij.⁵⁹ Lasgush Poradeci njeri dhe filozof do të vazhdojë ta nxisë kërkimin tonë edhe në të ardhmen. Dëshmia ndërkaq që lejon të vështrosh në atë pjesë të qenies së tij, të lidhur me frymëzimin krijues me rrugët dhe çfarësinë e petkut që u vesh me shqetësime dhe vizionit të vet gjatë artikulimit gjuhësor të tyre... dhe në mbështetje të këtij universi, disa supozime mund të dalin si më të qëndrueshme. Për shembull është më se e qartë se Lasgush Poradeci ishte fare i ndërgjegjshëm për praninë e gjeniut në vete ishte i ndërgjegjshëm për se është i ndryshëm dhe i veçantë nga të tjerët... Në përputhje me këtë vetëdije, Lasgushi sillej dhe krijonte relacione me të tjerët, me lirinë, me

⁵⁸ Sami Krosi, “Filozofia e jetës në poezinë e Lasgush Poradecit”. Shkup, 1998, f. 57

⁵⁹ Ali Aliu, “Shtengim metafore”. Toena, 2006.

atdheun... Ishte po ashtu i ndërgjegjshëm se sillte dhe shënonte kthesën, thyerjen e madhe, më origjinale, më kreative në botën tonë poetike. Lasgushi e ndiente qartë, po ashtu, praninë e një fryme (shpesh do ta formulojë si mall poeti) dhe zjarri të vetvetishëm nga brenda që e përthithte dhe valë-valë i vërviste majat qiellore, valë e zjarr që ishin burim i pashtershëm dhembje dhe gëzim. Dhembja dhe gëzimi krijues si bukuri përmes vargut të tij, arrijnë të formësohen si figura të qarta në vizionin vegimtar të poetit. Edhe atëherë kur poezia e Lasgushit duket si farë tokësore, ajo përherë gjendet si e mbështjellë brenda një ylberi të vegimshëm.⁶⁰

2.8. Moderniteti dhe risitë e poetikës së Lasgush Poradecit

Lasgush Poradeci është i pari poet modern dhe një nga lirikët më të mëdhenj shqiptar të shek. XIX. Dy librat e tij poetikë “Vallja e yjeve” dhe “Ylli i zemrës” u botuan në vitet ’30.⁶¹ Poezia e tij qëndron larg së qeni romantike dhe e angazhuar në krahasim me poezinë e periudhës së Rilindjes Kombëtare. Ajo dallohet nga mendime të thella, ndjenja labirintike e ide të fuqishme universale. Kjo poezi solli një ndjeshmëri të re në letërsinë shqiptare të viteve ’30 stili, një kërkim të thellë gjuhësor të formës e një figuracion të rrallë stilistik. Në të gjitha poezitë e Lasgushit shprehet hapur koncepti se artisti i madh krijon për vete dhe misioni i artit të tij është t’i transmetojë lexuesit kënaqësi e mesazhe estetike. Me veprën e tij poezia shqipe njohu praninë e pikturës dhe muzikës në ndërtimin e lirizmit poetik më shume se çdo herë më parë. Me veprat poetike “Vallja e Yjeve” dhe “Ylli i zemrës” ai krijoi një sistem unik poetik. Poezia e tij për gjuhën shqipe njeh figurën origjinale, formën e re dhe ndjeshmërinë e papërsëritshme në letërsinë tonë. Ai solli një model krejt të ri të lirikës në poezinë tonë, duke e trajtuar atë si problem filozofiko-estetik, ndaj dhe zgjidhja që ai ofron përmes vargjeve është absolute. Koncepti prej reformatori mund të konceptohet bazuar në shenjen e veçantë të ndjeshmërisë, që ai e sintetizon në formë dhe përmbajtje. Ai përdorte gjuhën metaforike. Në veprat e tij, ai përfshiu modernitetin duke i dhënë praninë e pikturës, muzikës në ndërtimin e lirizmit poetik dhe duke dhënë tiparet simboliste të krijimtarisë së vet. Tek vëllimet poetike “Vallja e yjeve” dhe “Ylli i zemrës” si rrallëherë në poezinë shqipe vjen një magji e pastër e një gjuhe simboliste e cila nëpërmjet renditjes logjike të mendimit, objekti poetik sjell fillesat e lirikës moderne shqiptare. Tek poezitë e tij ai përpiqet në mënyrë të vazhdueshme për

⁶⁰ Sami Krosi, “Filozofia e jetës në poezinë e Lasgush Poradecit”. Shkup, 1998, f.60

⁶¹ Ilir Shyta, Bibliografi e autorizuar për jetën dhe veprën letrare të Lasgush Poradecit.

reformimin e gjuhës së pastër shqipe. Poezia për të ishte tempull shpirtëror dhe mediativ. Çdo ndjenjë e pasqyronte në mënyrë origjinale si p.sh. dashurinë, të cilën e ndjen dhe e kupton si fuqi të pashtershme. Lasgushi krijoi poetikën origjinale, në të cilën ngrihet një univers emocionesh, idealesh, në të cilën vendosi botën shqiptare. Në ciklet e tij dallohen poezitë e peizazhit, poezitë erotike, poezitë patriotike dhe poezitë reflektive. Ai solli letërsisë shqipe në forma të reja metrike (rondeli dhe trioleta) por njëherësh edhe i gdhendi dhe i përpunoi të vjetrat pothuajse deri në përkryerje. Krijimin e tij Poradeci e mbështeti në katër figura elementare: qielli, dheu, uji dhe zjarri, të cilat janë edhe temat e përhershme të poezisë së tij.⁶²

2.9. Përfundime mbi poetikën lasgushiane

Llazar Gusho, alias Lasgush Poradeci, që me krijimet e para goditi në shenjë. Ai zgjoi interes të posaçëm ndër shtresa të ndryshme lexuesish. Vepra e tij letrare u bë objekt receptimi aktiv pas botimit sporadik të poezive të tij të para në shtypin e kohës gjatë viteve '30. Botimi i vjershave ishte një faktor që ndikoi dukshëm në kërkimin e lexuesve. Duhet të themi se atij i paspru jehona e vlerës artistike të poezive dhe përjetimi i thellë estetik që krijohej prej tyre, në horizontin pritës. Në këtë skemë padurimi kishin dhënë kontributin e tyre edhe shumë autorë të tjerë të viteve '30, por duhet thënë se vepra poetike e Lasgushit me strukturën e saj letrare befasoi shijet e lexuesve, duke iu shkaktuar atyre një prangim të fortë artistik. Këto risi të pranuar qenë sa në aspektin tematik aq edhe në atë struktural poetik. Idetë, temat, motivet, mesazhet ishin në përgjithësi si ato të autorëve të tjerë bashkëkohës të Lasgushit, mirëpo trajtimi i tyre, veçmas ai i dashurisë, kishte fatin e tërheqjes artistike. Brezi të cilit i përkiste Llazar Gusho ishte i shoqëruar nga dy faktorë themelorë, shkollimi jashtë vendit dhe rikthimi i tyre në atdhe për t'u bërë pjesë e rrethanave politoko-shoqërore. Autorët e këtij brezi i shprehën pikëpamjet mes krijimeve poetike, por edhe manifestimeve të ndryshme letrare. Këto krijime u bënë më pas, zëdhënëse estetike të idealeve dhe synimeve të kohës.⁶³

Me cilësinë e krijuesit të ndjeshëm dhe modern njëherazi, Lasgushi kishte kuptuar herët, se poetika dhe arti në përgjithësi duhet të mbështeteshin fort, në aspektin social. Vepra letrare e Lasgushit mbeti e pavarur si një strukturë e hapur artistike që mposhti tallazet që i vinin nga drejtime të ndryshme intelektuale dhe politike të kohëve. Kjo sulmnajë, bëri që poezia mos

⁶² Sami Krosi, "Filozofia e jetës në poezinë e Lasgush Poradecit". Shkup, 1998, f.62.

⁶³ Ilir Shyta, "Receptimi i poezisë së Lasgush Poradecit". Tiranë, 2015 (Disertacion), f. 136

prekej a bëhej plagëshumë. Përkundër më gurët që i hodhën sipër, vepra poetike e Poradecit ndërtoi themele më të forta qëndrore në vitrinën e viteve. Në këtë kuadër vetë kjo estetikë e pasqyruar poetikisht e artistikisht si edhe gjerësia e saj ndikuan në përvetësimin e receptimit e madh në vite, nga ana e publikut lexues. Vlerat e mirëfillta artistike, në artin poetik lasgushian i kuptoi në vitet e para të saj edhe kritika letrare. Në fillim ajo dha gjykime të përgjithësuara, deklarative dhe sentimentale që i karakterizonte toni romantik.

Vepra e Lasgush Poradecit në poezi, por edhe shënimet e ndryshme apo ditarët, japin mundësi të një shqyrtimi edhe më të gjithanshëm se kaq. Struktura e krijimeve të tij poetike mbetet e vlefshme për një analizë më të thellë në rrafshin fonologjik, morfologjik, sintaksor apo semantik.

Tematikën e tij, veçanërisht motivin e dashurisë ai e trajtoi me një poetikë të re. Konkretisht, ajo në poezi qëndron më së shumti në thyerjen e konvencionit letrar tradicional dhe në inaugurimin e elementëve të rinj, në aspekt të metrikës, fjalëformimit dhe veçanërisht figuracionit. Raporti krijues, gjuhësor i përdorur në poezi është ligjërimi qytetas, duke ndryshuar fund e krye nga një pjesë autorësh të tjerë të kohës lasgushiane. Figuracioni poetik çdo herë tenton të arrijë në strukturën e poezive, jo vetëm figura të qëndrueshme, të trashëguara nga ngjashmëri letrare, por edhe kuptimin kontekstual. Lasgush Poradeci thelloi me poezinë e tij distancën e arsyeshme estetike ndaj traditës. Kur është fjala për motivet, për tematikën dhe në përgjithësi për lëndën letrare autori mbështet deri diku në traditën e kohës, pastaj në letërsinë bashkëkohore e veçmas në orientimin e autorëve të viteve '30.⁶⁴

Lasgushi është i prekshëm ndaj elementëve kombëtare, qoftë në aspektin tematik, qoftë në aspektin artistik. Ky është një faktor që veprën e tij e bën më të begatshme në aspektin e elementit semantik.

Si përfundim, theksojmë se tekstet letrare janë receptuar në periudha të ndryshme kohore katër herë nga lexuesi. Leximi i parë i përket periudhës 1928-1939, kohë kur autori shkruan, boton dhe përcillet nga lexuesi në mënyrë legale. Ky ishte një lexim normal, me një nivel po normal receptimi dhe interpretimi. Leximi i dytë, vendoset në periudhën 1940-1944, kohë kur autori sërish preferohej ndër shqiptarë, me vargjet e tij. Prosesi honorizues u zbeh disi për shkak të luftës, por gjithsesi ai ekzistoi. Leximi i tretë i përket Shqipërisë së udhëhequr zyrtarisht nga komunistët. Në atë periudhë autori dhe vepra e tij do të ribotoheshin. Më tepër

⁶⁴ Ilir Shyta, "Receptimi i poezisë së Lasgush Poradecit". Tiranë, 2015 (Disertacion), f. 137

se një lexim rigoroz, ishte një oshëtimë leximi. Lexuesi dhe kritikët e privilegjuan Lasgushin, duke i dhënë jehonë më të madhe veprës së lexuar, por të lënë në hije nga sistemi totalitar. Leximi i katërt nisi pas viteve '90 e vijon ende. Ky është leximi dhe interpretimi më i sigurt se tre të parët. Skema e komunikimit estetik është e plotë dhe shumë e pranueshme.⁶⁵

⁶⁵ Ilir Shyta, "Receptimi i poezisë së Lasgush Poradecit". Tiranë, 2015 (Disertacion), f. 139

3. Poemat e Lasgushit Poradecit

3.1. Ekskursioni teologjik i Sokratit

Poemat “Ekskursioni teologjik i Sokratit”, mund të konsiderohet një nga poemat më të mira të Lasgush Poradecit, i cili nga pushteti i asaj kohe quhej poet i heshtur, mirëpo me daljen e poemës vërtetohet që poeti gjatë gjithë kësaj periudhe kishte punuar duke finalizuar punën e tij me 1978 me botimin e poemës, e cila shfaqet si lloj hakmarrje poetike për individët, që pretendonin se poeti ishte i heshtur dhe nuk shkruante.

Lasgush Poradeci u shfaq e mbetet si një kulm i lartë në poezinë shqipe të shekullit të XX, jo vetëm me frymëzimin e thellë, ndjenjën njerëzore, idetë dhe motivet interesante, po edhe me stilin origjinal e fjalën e figurshme, ashtu si di ta flasë edhe ta shkruajë vetëm ai. Dhe për këtë anë të stilit të tij origjinal dhe brilant, sipas Mitrush Kutelit, Lasgush Poradeci është një “autarkist” i cili i nxjerr të gjitha metaforat e simbolet vetëm e vetëm prej gjuhës shqipe, prej realiteteve e mundësive të gjuhës shqiptare, prej etikës shqiptare. Ai përpiqet të vleftësojë e të zhvillojë potencialin shqiptar në art në të gjitha degët e jetës.

Kështu Lasgushi kishte gjetur një gjurmë të re në fushën e figuracionit e të leksikut, atë që në një vjershë më të vonshme do ta shprehë këtë:

*Hija ime nuk di dhunë,
Di veç frymë lirie
Dhe di punë, punë, punë,
Mund pa fund për art magjije.
Dhe të shoh të pasqyruar
Vetëveten fije-fije,
Fije-fije poezie,
Që mbanë erë Shqipërie⁶⁶*

Po me gjithë pohimet e Kutelit se në të gjithë vargjet e Lasgushit nuk ka asnjë emër ose fjalë të huaj, se ai mban vetëm erë Shqipërie në vjershëri, ashtu sic e thotë edhe vetë poeti në vargjet e mësipërme, në poezinë “Kush ma njohu dhembshurinë”, gjejmë një dalje nga rruga. Në këtë vjershë autori parapëlqen të bëjë një krahasim me një emër të madh nga antikiteti

⁶⁶ Eqrem Çabej, “Mbi poezinë e Lasgush Poradecit”.

grek. Duke shkruar për stoicizmin e vetë ndaj brengave, mundimeve dhe hidhërimeve, poeti pohon se jeta:

Qoftë e ëmbël si një çupë, Qoftë e mbushur plot me gjak;

Do t'ia pi të shkretën kupë,

Siç e piu Sokrati plak⁶⁷

Ku ta gjejmë shkakun e daljes së poetit nga drejtimi i vetë poetik, që vetëm mban erë Shqipërie. Për dekada të tëra këtë gjë e dinte vetëm autori, ndërsa të tjerët nuk e besonin. Po nga fundi i viteve '80 të shek. XX në redaksinë e autorëve të traditës pranë shtëpisë botuese “Naim Frashëri” filloi puna edhe me veprën letrare të Lasgush Poradecit. Ky botim do të ishte më i ploti i kësaj vepre deri atëherë me një vëllim prej 520 faqesh, ku përfshihej gjithë poezia e tij e botuar, shkrimet në prozë, dorëshkrime dhe letërkëmbimi. Midis dorëshkrimeve ndodhej edhe poema “Eskursioni teologjik i Sokratit”, e cila qe përfunduar qysh më 1978. Kështu pra, në poezinë e Lasgushit bëhet e pranishme përsëri figura e Sokratit, po tani jo me një varg, po me një poemë prej 24 faqesh, pas një heshtje të gjatë të shkrimit të Lasgushit. Arsyeja e parë pse figura e Sokratit antik del si personazh në poezinë lasgushiane dhe autori bën kështu një dalje nga rruga krijuese është vetë universaliteti i figurës së Sokratit, i cili kishte kaluar prej shekujsh kufijtë e lashtësisë helene. Nga ai kanë shumë për të mësuar të gjithë në çdo vend e në çdo kohë.

Duket nga poema në fjalë se edhe Lasgush Poradeci i ka bërë përshtypje të jashtëzakonshme ashtu si jeta dhe vepra e Sokratit, po edhe vdekja krenare e filozofit të madh. Poema “Eskursioni teologjik i Sokratit” është shkruar në formën e kërkimit të së vërtetës shoqërore, ku Sokrati zbulon mashtrimin, sepse kishte shpallur këtë mashtrim dhe me këtë kishte rrënuar edhe ëndrrën për një pushtet të rregullt që ishte i drejtë me popullin.

Figurat kundërshtuese në këtë poemë janë pushteti i përfaqësuar nga kryegjyqtari, kryepushtetari dhe kryepriifti si tri nivele të pushtetit manipulues dhe populli, të cilët janë të manipuluarit, si dhe Sokrati i cili mundohet t'i bindë popullin për mashtrimet që po ju bëhen.

Sokrati qe i biri i skulptorit Sofraniku i cili që në vegjëli nisi të punonte si gurgdhendës. Po nga viti në vit, gjithnjë e më shumë djaloshti zgjeronte edhe njohuritë e veta duke mësuar me këmbëngulje. Ashtu, ai arriti të bëhej filozof. Si njeri i etur për dituri, thoshte: “Di një gjë, që

⁶⁷ Lasgush Poradeci “Ylli i Zemrës”. Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 134.

nuk di asgjë”. Si rregull të jetës së tij Sokrati mori mbishkrimin e tempullit të Delfit: “Njih vetveten”.⁶⁸

Si filozof me mendime të thella, Sokrati u ngrit kundër sofistëve, të cilët nga mësues të gojëtarisë ishin kthyer në njerëz të korruptuar që përpiqeshin në mënyra të rreme të mbronin ose të rrëzonin si të drejtën ashtu edhe të shtrembëtën, sipas interesit.

Qëllimi kryesor i Sokratit ishte të përhapte njohuri dhe të ngjallte tek njerëzit dashurinë për dituri. Në praktikën mësimore ai nuk jepte kurrë përgjigje të gatshme, po përpiqej që me anë të pyetjeve dhe përgjigjeve ta shpinte bashkëbiseduesin në përfundime logjike të drejta. Kjo mënyrë e të mësuarit do të quhej më vonë në pedagogji “metoda sokratike”.

Nëpërmjet bisedave filozofike me nxënësit e tij dhe me rininë e asaj kohe antike, Sokrati përhapte idetë e tij të përpunuara, që bënë ndesh me shumë norma të shtetit, të gjyqeve edhe të fesë shtetërore. Nga dita në ditë ai po kalonte në një konflikt të hapur me shoqërinë e lartë zyrtare të shtetit të Athinës. E qortuan dhe e këshilluan të hiqte dorë, po Sokrati s’ tundej nga parimet e tij. Atëherë autoritetet laike dhe fetare e nxorën në gjyq.

Sipas Platonit, “Sokrati që nxjerrë në gjyq në vitin 399 P.K me akuzën se po shpërfillte perënditë shtetërore dhe po paraqite perëndi të reja, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër akuzohej se po korruptonte moralisht rininë, duke e larguar nga principet e demokracisë.”⁶⁹

Në radhë të parë Sokrati donte se filozofia të merrej me problemet e jetës në tokë dhe jo të endej nëpër qiej, nëpër sferat rrotullore, po të ishte fizikë me themelet natyrore. Dhe për këtë ide realiste të heroit të tij filozof, Lasgushi shkruan në poemë:

*Filozof Sokrat i vjetër
Kokë e vlefshme e Greqisë
E pat zbritur përmbi tokë
Lëndën e filozofisë*

Krahas filozofisë, Sokrati kujdesej edhe për normal morale. Ndryshe nga sofistët e korruptuar, ai donte të vendoseshin marrëdhënie të ndershme e të sinqerta midis shtetit dhe popullit. Po ashtu donte edhe drejtësi të paanshme për palët në gjyq. Dhe për këtë anë të prirjeve morale të Sokratit Lasgushi shkruan në poemë:

⁶⁸ A. Mushulin, “Historia e kohës së vjetër”. Tiranë, 1950, f.141.

⁶⁹ Irving Edman, “The works of Plato”. f. 67.

*Përcaktove dhe moralin,
Përcaktove drejtësinë.
Dhe ngarkove për detyrë
Vec njërinë, vec njërinë.
Moral të bukur shumë
Për dobi të gjithësisë
Që i shërbente drejtësisht
Njerëzisë dhe shoqërisë.
Si vendose paq moralin
Mbi themele të patundur,
Kape zotërit e Fenë
Për t'i tundur, për t'i shkundur.*

Ashtu si në jetë edhe në poemën e Lasgushit, heroi filozof ka përpara shumë kundërshtarë parimorë, të cilëve përpiqet t'u mbushë mendjen për të vërtetën dhe t'i bindë. Dhe këta kundërvënës nuk janë vetëm nga radhët e sofistëve, por edhe nga paria e administratës shtetërore, gjyqësore dhe hirearkia klerikale në shtetin e Athinës. Në këtë atmosferë konfliktuose nis atëherë Sokrati ekskursionin e vet filozofik e teologjik tek personalitetet më të larta të kohës, për të shpjeguar probleme sociale, filozofike e fetare. Në fillim shkoi te kryeshtetasi antik, pastaj te kryegjyqtari, dhe, më në fund, në tempull gjeti kryepriftin vetë.⁷⁰

Heroi filozof i poemës së Lasgushit, vërtet u end nga një personalitet tek tjetri, për të parashtruar shqetësimet e veta, po asgjë nuk zgjidhi dot në këtë ekskursion. Jo vetëm se nuk ia dëgjuan vërejtjen e kritikës, po përkundrazi e qortuan. Së pari, e kërcënuan të mbyllte gojën, sepse përndryshe do ta pësonte keq. Vetë prifti e paralajmëroi se:

*Sa për ty Sokrat, që shan
Perënditë shtetërore,
Dhe përhap ide të reja
Dhe zgjon masat popullore
Thonë se do të dënojnë
Rreptësisht për këtë faj,
Me që do kryeparin,
Ta rrëzosh nga froni i saj.*

⁷⁰ Sami Krosi, "Filozofia e jetës në poezinë e Lasgush Poradecit". Shkup, 1998, f.137.

Po Sokrati që kishte një karakter të ngurtë, nuk trembej nga paralajmërimet frikësuese. Po edhe kleriku i lartë, nga ana e tij, nuk e la me kaq kërcënimin. Për më tepër, ai, duke dashur ta frikësojë me dënimin maksimal, i deklaroi:

*Thonë gjyqi dhe tërë Athina
Se ty do të dënojnë,
Të pish kupën e zeherit,
Që kështu të asgjësojnë.*

Realisht siç e trajton Platoni tek “Apologjia”, Sokrati ka qenë jo vetëm filozof i ditur, po edhe trim i patrembur, e mbi të gjitha superior ndaj kundërshtarëve e gjyqtarëve të kohës. Me gjithë presionet që iu bënë, ai nuk i mohoi pikëpamjet e tij dhe nuk pranoi të ndërpriste dhënien e mësimëve të filozofisë: “Burra të Athinës, -flet ai në gjyq, -unë u dua dhe u nderoj, por para jush do të dëgjoj zotin. Dhe për sa kohë që jam gjallë dhe jetoj, unë kurrë s’do ta ndërpresë dhënien e mësimëve të filozofisë”.⁷¹

I patrembur nga imazhi i vdekjes, Sokrati nuk pranonte të largohej nga burgu edhe kur shokët e miqtë i siguronin mundësinë e arratisjes. Në momente të tilla dramatike ai deklaronte se “Asgjë e keqe nuk do t’i ndodhte njeriut të mirë as kur jeton e as mbas vdekjes”.⁷²

Si filozof krenar e i patunduar në bindjet e tij për jetën dhe vdekjen, për të vërtetën dhe mashtrimin, për drejtësinë dhe padrejtësinë, ai u shpreh para trupit gjykues dhe spektatorëve se “E vështirë, o miqtë e mi, nuk është të shmangësh vdekjen, po të shmangësh padrejtësinë”.⁷³

Po ashtu edhe Sokrati i poemës së Lasgushit është njeri guximtar dhe i urtë, i palëkundur në rrugën e tij që s’pranon asnjë kompromis. Lasgushi nëpërmjet filozofit antik dëshiron t’i shemb idetë totalitare të diktaturës së Shqipërisë së asaj kohe. Kryepriifti mundohet ta josh me shembullin e tij jo të administrueshëm për njeriun e ndershëm:

*U bubu, Sokrat, Sokrat,
Filozof që tunde dhenë,
Po si ne or antizot,
Pse s’bën kompromis me fenë?*

⁷¹ Irving Edman, “Platon”. f.74.

⁷² Irving Edman, “Platon”. f.74.

⁷³ Irving Edman, “Platon”. f.85.

Po kjo këshillë e klerikut të lartë që krejt e papranueshme për heroin e poemës së Lasgushit. Sokrati edhe në poemë nuk del nga bindjet filozofike, nga parimet e jetës tij dhe as nuk korruptohet. Në mënyrë të prerë Sokrati pohon para klerikut të Zeusit, se ai s'ishte për kompromis me fenë. Pasi për njerëzit e ditur deja nuk është përzierje dogmash. Duhet bërë e qartë, deklaroi Sokrati, se për ne të diturit:⁷⁴

*Feja jonë është trefish,
Shkencë e art e poezi,
Zoti ynë është një fish
Ky quhet Dituri.*

Në këtë mënyrë pra, kuptohet nga pushtetarët e kohës në Athinë, se Sokrati nuk vinte mend. Ai shkante në popull dhe përsëri predikonte parimet e tij. Kjo i revoltonte qeveritarët e kohës. Ai po shpërndante ide të reja për të ardhmen, gjë kjo që s'u pëlqente njerëzve të regjimit sundues. Ai po u prishte qetësinë qeverisëse po hapte "punë", pra po prishte marrëveshjen. Atëherë të alarmuar ata i thonë:

*Prap po i mohon Sokrat
Perënditë shtetërore,
Prap ti me ide të reja
Po zgjon masat popullore.*

Më në fund u pa e qartë prej parisë se Sokrati nuk që thyer nga paralajmërimet kërcënuese, se nuk po pranonte as rrugë kompromisi. Atëherë për atë kishte vetëm një alternativë, ajo e gjyqit:

*Kështu me ndërgjegje të ashpër
Merr vendim gjyqi zhelat,
I jep kupën e zehurit
Të pamposhturit Sokrat.
Kështu djajtë e bestytnisë,
Kështu breshkat e Moçalit
Vranë filozof Sokratin,
Madhështorin dre të malit*

⁷⁴ Petraq Kolevica, "Lasgushi më ka thënë". 8 Nëntori, Tiranë, 1992, f.40

Lasgush Poradeci në të njëjtën kohë, kur lartëson figurën e Sokratit, qartë edhe idenë se ai u dënua për pikëpamjet e idetë e tij progresive, duke u bërë martirë i doktrinës së vetë filozofike. Që atëherë, që nga viti 399 P.K, kur u dënua Sokrati e deri tani, kanë kaluar 24 shekuj, po emri dhe vepra e tij jeton në faqet e historisë, prandaj poeti shkruan për pavdekësinë e tij:

*Ti m' i miri, ti m' i urti,
Ti m' i drejti gjithë Greqisë
Vdiqe përmes errësirës,
Linde përmes historisë.
Shkuan vjet dhe qindra vjetë,
Shkuan edhe mijra vjet.
Të nderon Sokrat njerzimi,
Mirënjohje jetë pas jete.*

Në favor të kësaj ideje së Sokrati rilind përmes historisë është edhe mendimi i studiuesit amerikan J.F. Stone, i cili në veprën e tij “The Trial of Sokrates” shkruan: “*Sokrates speaks like a modern civil liberatorian*”⁷⁵; ose e thënë shqip, Sokrati flet si një liberator modern i qytetëruar. Nga kjo pikëpamje Sokrati nuk është vetëm një filozof dritëdhënës i antikitetit, por edhe një liberator i gjithë kohëve moderne. Nga kjo anë ai është një mendje universale, që ndrin në shekuj për logjikën e hekurt dhe guximin qytetar. Filozofi Sokrat që në opozicion me qeverisjen e kohës së tij jo si një grindavec për gjëra të vogla personale, po për çështje madhore, për të drejtën, për të vërtetën, për lirinë.

Ai ishte dijetari që donte ndryshime për të mirën e shoqërisë, që nuk dinte të bënte kompromise, që kurrë nuk mund të bëhej vegël e shitur te qeveria, që mudohej me shpirt për të mirën e popullit e jo për përfitimet e veta personale. Njerëzit mendjendritur dhe të guximshëm si Sokrati i duhen çdo kohe, po e keqja është se opozitarë të tillë prishin rehatinë dhe nuk u duhen qeverive. Cili filozof shkoi aq i vetëdijshëm drejt fundit tragjik si ai. Për mendimin e thellë filozofik dhe guximin e tij, Sokrati është një sinekdotë; dhe ashtu siç themi me muzeumet kanë nevojë për Ciceronë, që të kuptohen nga të gjithë, kohërat kanë nevojë për Sokratë, që të ndriçohen.

⁷⁵ J. F. Stone “The trial of Sokrates”, f. 210.

Lidhur me fatin tragjik të filozofit të madh, si në jetën e tij edhe në këtë poemë, që jemi duke analizuar, studiuesja Frida Idrizi ka shënuar në parathënien e veprës letrare të Lasgushit se “Poeti duke marrë shkas nga figura e Sokratit, demaskon në poemën “Ekskursioni teologjik i Sokratit” hipokrizinë politike, klerikale dhe etike mbi të cilën mbështeten gjithë rendet shfrytëzuese, për të vënë në gjumë popullin e lënë në padije, me qëllim që të zgjasin sa më shumë jetën e tyre”.⁷⁶

Herezia e filozofit krenar ndaj Zeusit Sovran si dhe qëndrimi i tij kritik ndaj “parisë” drejtuese është cilësia më dalluese e Sokratit, që i ka tërhequr më shumë vëmendjen poetit në poemë. Kjo për arsyen se edhe vetë Lasgushi në këtë aspekt është një “Sokrat në miniaturë”. Sepse edhe vetë dëshira e autorit është të identifikohet me heroin moral të tij që ishte Sokrati.

Ai nuk e vuri penën as në shërbim të monarkisë, as në favor të diktaturës komuniste. Shkurt poeti nuk i përfillte qeveritë edhe sferat e larta drejtuese. Po edhe ata të kabineteve të larta zyrtar e dinin fare mirë këtë gjë, prandaj, pa u ndjerë, qeveritarët e linin në hije. Dhe për këtë veçori të Lasgush Poradecit bindesh kur lexon epistolarin e tij, sidomos letërkëmbimin me Asdrenin, me E. Çabej, si dhe me S. Luarasin.

“...O miku im i dashur dhe atdhetar i urtë, Asdren... Studentët e ardhur nga Shqipëria thonë se arka e shtetit qenka zbrazur nga shkakut i festave të kurorëzimit, prandaj s’po dorëzohen bursat prej kaq muajsh dhe kush e di se gjer kur do të zgjatet ku martirizim...”⁷⁷

Për ta ndriçuar edhe më shumë alergjinë e Lasgushit ndaj nëpunësve të lartë qeveritarë le të lexojmë edhe letrën që i drejtonte E. Çabejit nga Graci më 29 shkurt 1933: “Me pedantsuan obskurantisht, po un nuk u betova. (.....). Pasi bërë skandalin e mosbesimit, na ardhke edhe për rrogë tani... Unë i ofenduar, dhe gjigand kundër pigmenëve nuk u tremba, po erdha pa rrogë.” – (Vep. Letrare, f.483). A nuk janë këto shembuj që flasin për një Sokrat në miniaturë? Për një poet që nuk u shit te politika, por që qëndroi si Princ në mbretërinë e Poezisë.

Së fundi, duhet theksuar se mendimet dhe idetë e poemës “Ekskursioni teologjik i Sokratit” janë dhënë përmes një forme tërheqëse nga ana artistike, edhe pse në këtë vepër nuk e kemi më atë erotikën e afetuar nga një dashuri zhuritëse, ashtu si tek “Ylli i Zemrës” apo tek “Vallja e Yjeve”, apo edhe te vetë poema tjetër “Kamadeva”, që po ashtu është objekt

⁷⁶ Frida Idrizi, “Vepra letrare e L. Poradecit, Parathënia”, Tiranë, 1990, f.18.

⁷⁷ Lasgush Poradeci, “Vepra letrare”, Tiranë, 1990, f.47.

studimi i këtij punimi. Vendin e heroit lirik në këtë poemë e zë një filozof i ndritur dhe me karakter të fortë. Po edhe kjo dukuri e re në poezinë e Lasgushit, tanimë në moshën të tretë, jepet me frymëzim.

3.2. Kamadeva

Lasgushi i këndon dashurisë, si një ndjenjë e thellë që e përcjellë gjatë gjithë jetës së tij, si një ndjenjë që e beson dhe që e trondit njëkohësisht. Te ato tingëllon i veçantë zëri i tij, figuracioni origjinal dhe variantet e ndryshme të ndjenjës së thellë. Lasgushi shkruante vepra të mëdha për dashurinë duke bashkuar magjinë, erotikën, universalizmin, modernitetin dhe njëherazi frymën autoktone të mbështetur tek poezia popullore dhe këtë e shpreh në të dy librat poetikë të tij “Vallja e Yjve” dhe “Ylli i Zembrës”, por edhe në poemën e pleqërisë “Kamadeva”, ku paraqet aq mirë gjendjen shpirtërore të tij në një moshë të shtyrë.

Lasgush Poradeci është nga lirikët shqiptarë më të shquar, i cili u shqua për sendibilitetin dhe ëmbëlsinë poetike, figuracionin me të cilën i këndoi atdheut dhe dashurisë, por i këndoi edhe mallit, të bukurës, trimave, e gjithë kjo me një shpirt poetik e një gjuhë e leksik të pastër me fjalë të vjetra shqipe, të sistemuara në poezinë e vet.

Është thënë se Lasgushi ka shkruar edhe gjatë “heshtjes” së tij, d.m.th. edhe gjatë kohës kur vepra e tij nuk është çmuar sa duhet, ka shkruar Kamadevën e tij (poemë e dashurisë), në të cilën ka punuar tridhjetë vite, por nuk ka mundur ta botojë kurrë për të gjallë të tij...

Çabej thotë për të: “Ç’ e ndryshon nga të parët është thellësia... është vjershëtori më i thellë që ka shkruar në shqipet; në qoftë se kjo nuk është vënë re gjer tani, shkaku është se më të shumtët nuk e kuptojnë poezinë e tij, e cila me fjalë e mënyra foljesh fare të thjeshta, e shumë herë popullore, arrin të koncentrohet aq sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat më labirintike, idetë më të larta. Dhe po të këndohet Lasgushi me dashurinë, do të vërtetohet thellësia e tij e pashoqe, në mos sot, nga brezat që do vijnë”.⁷⁸ I thënë në kulmin e krijimtarisë së Lasgushit ky mendim nga Çabej, më duket se edhe sot është më aktual dhe më i vlerësuar për të.

Që në fillim të poemës paraqet gjendjen shpirtërore të tij, ndjenjat e kujtimet e rinisë, vendin e takimeve.

⁷⁸ Eqrem Cabej, “Mbi poezinë e Lasgush Poradecit”.

*Mendoj e shkoj nga pak
Si gjithëmonë,
Me shpirtin zemërak
Në rrugën tonë
Atje ku ma ringjall
Aq letë e qetë,
Në gjirin tim një mall
Të mjerën jetë*

Dhe jo vetëm në fillim paraqitet malli për të dashurën, por edhe në vazhdim të poemës, sepse botëkuptimi i tij është idealist dhe kjo lë gjurmë sado të vogla, atëherë kur ai i këndon me ëmbëlsi vashës dhe natyrës shqiptare. Një tjetër figurë që spikatë në poezinë e tij është malli. Malli është një nuancë e poezisë së dashurisë, si ndjenjë universale, por e cila mban në vetvete edhe dhimbjen e nostalgjinë. Edhe në poemën “Kamadeva”, figura e mallit vërehet shpesh.

*O mall! O dashuri
O yll! O djellë!
Sesi më djeg në gji,
Në zemër fellë!
Sesi më ndjell që larg, Më ndrit përfare,
Me dritat varg e varg
Vetetimtare!*

Se dashuria për Lasgushin është fuqi themelore jetësore e tokësore e qiellore,⁷⁹ vërehet shumë në këtë poemë, sepse poezia e dashurisë së Lasgushit shfaqet më e arrirë në lirikat personale të tij, sepse dashuria për të është vetë kuptimi i jetës. Siç thotë edhe studiuesi Hamiti në librin “Lasgushi qindvjeçar”: “*Lasgushi përforcon tezën, se nuk ka lirikë të madhe pa dashurinë*”, këtë tezë e përforcon edhe më tepër në veprën e tij të fundit poetike “Kamadeva”, të cilën nuk arriti ta botonte sa ishte i gjallë.

Lasgushi në poemën “Kamadeva”, vërteton fjalët e tij se dashuria është ndjenja më e pastër, ndjenja më e fortë e njeriut.

...O natë! O ëmbëlsi!

⁷⁹ Sabri Hamiti, “Lasgushi qindvjeçar”, Prishtinë, 1999.

Limer i fshehtë!
O mall! O dashuri!
Përgjithëjetë!

Lasgush Poradeci është njëri nga poetët që hap një etapë të re në letërsinë shqipe, atë të njeriut me botë intime, diskrete, botë e ëndrrës të misterit dhe të erosit njerëzor, botën e njeriut në procesin e njohjes së universit dhe të vetvetes, të ekzistencës dhe përjetësisë, të mallit e dashurisë, trishtimit dhe gëzimit, të njeriut në provën e identifikimit, e kjo mjaft mirë vërehet edhe në poemën e dashurisë “Kamadeva”.

Poeti në mënyrë të qartë shpreh ndjenjat e dashurisë në poemën “Kamadeva”, shpreh mallin, dëshirën për jetë, nostalgjinë për vashën, të cilën herë e quan dashuri, herë shoqëze, e herë motra ime, sikur me këta emra do ta zmadhojë figurën e gruas në maksimum dhe e cila ndonjëherë del si figurë popullore shqiptare, që vendos si simbol të vazhdimit të jetës. Këto emërtime të femrës shqiptare nuk vërehen vetëm në poemën “Kamadeca”, por edhe në poezitë e tjera të poetit me temë të dashurisë. Këndimi i dashurisë sipas traditës shqiptare të Lasgushi mbështetet nga jeta e vendit dhe figura e mbindërtuar popullore.⁸⁰

Lasgushi në poemën e tij paraqet dashurin për vashën me ndjenjën më të thellë e më të pastër, paraqet takimin e tyre ku përshkruan me detaje takimin e tyre në pyll, ku dallon nga larg duke ardhur vashën e tij, ku e përshkruan si më të bukurën ndër shoqe.

...Dh'ashtu, posi dikur
Nga largësira,
Më del plot hir e nur
Ajo m'e mira.

Nër shoqe përsëri
Si në vegime,
Ngarkuar me stoli
Del shoqja ime.

Përshkruan në detaje takimin e tyre në buzëmbremje në kodrinë, dashurinë e zjarrtë që kanë për njëri-tjetrin, natën e bukur që kalojnë së bashku, ku me një përshkrim të detajuar përshkruan buzëqeshjen e vashës si buzëqeshje të mitur dhe skuqjen e saj si skuqje e virgjër,

⁸⁰ Petraq Kolevica, “Lasgushi më ka thënë”. 8 Nëntori, Tiranë, 1992, f.69

të pastër, pastaj mbarimin e natës dhe ardhjen e mëngjesit dhe vështirësinë e ndarjes nga vasha. Këndimi i dashurisë në frymën shqipe vërehet edhe në përshkrimin e vashës. Poeti në poemën “Kamadeva”, i këndon të dashurës bukurinë shpirtërore, po edhe bukurinë trupore.

Limeri u mbush përplot

Me shkrum e hije

Ne t'ikim s'ikim dot

Prej kaq magjije.

Dhe pas natës së kaluar nën qiellin e hapur në dritën e hënës dhe të yjeve, Lasgushi vashën e quan tani nuse.

...Dhe qeshte dashurisht

Moj dashurore,

Dh'u skuqe nuserisht,

Moj nuserore.

...Dhe n'atë përqaftim

Të lumturuar,

që zjen në shpirtin tim

Dyke valuar;

Lasgush Poradeci në poemën “Kamadeva”, i këndon dashurisë, vashës me të cilën dashurohet, kjo dashuri shijohet nga dy të dashurit, mirëpo dashuria e tyre nuk zgjatë shumë, sepse demoni i së keqes i ndan.

Edhe kur kënga e dashurisë merr trajtën e një forme dramatike me errësimin e disponimit të pushtuar nga dhembja edhe kur kënga e dashurisë shfaqet në trajtën e idilës gaztore, tekstin e Lasgushit e karakterizon thellësia e emocionit përpara të cilit përulet deri në dhe e ngritet deri në qiell.⁸¹

Kështu ndodh edhe në poemën e Lasgushit, fillon drama të zhvillohet me ndarjen e çiftit, e cila ndodh papritmas pa dhënë sqarime, tani poeti fillon e mallkon e vajton ndarjen...

I ndarje! Pëshjtjellim!

Pishtar i shuar!

⁸¹ Sabri Hamiti, “Studime letrare”. Prishtinë, 2003, f.400

*O Kamadeca im
Shigjetehelmuar;*

*Dhe ne po shtrydhim lot
Dëshpërimtare,
Ndaj vame e s'ardhme dot
Dh'u patme ndarë*

*Shëndrijme n'arrati,
Të ngashëryer
Ngjerojmë vrer e zi
Zemëre-thyer.*

Kjo është ndarja që përshkruan autori, ndarje e dhimbshme me zemër të thyer, autori ngarkon fjalët emocionalisht deri në maksimum duke bërë këtë të duket si gjuhë e zemrës, si gjuhë që buron drejtpërsëdrejti nga zemra e autorit, duke bërë të duket se vetë autori është personazhi i poemës. Në pjesën e dytë të poemës, autori e kërkon të dashurën në qiell. Kalon edhe hapësira shumë të mëdha, bile edhe një botë të tërë, për të takuar të dashurën dhe në fund e gjen.

*U hapen për cudi
Qiell e qendresë
Dhe posi perëndi
Del një krijesë.*

*Dhe zbriti përmi ne
Një gjeraqine,
Te prishe botë e dhe
Me bukurinë.*

*Dhe zbrite e re përposh,
Ti mos cudia,
Që dritën t'ua verbosh
Syve të mia.*

Lasgushi e gjen të dashurën në hapësirën kozmike, ku dashurohen përsëri me një dashuri të pastër e të madhe, shpirtërore, mirëpo kjo dashuri është dashuri imagjinare, qiellore, e jo tokësore dhe kërkon të zbresë përsëri në tokë, për të përqaftuar të dashurën, për të dashuruar atë me dashuri tokësore e jo qiellore sepse dashuria qiellore nuk e ngopë autorin.

*...Po sot edhe me s'di,
Jam a s'jam gjallë
Se mua kurrsesi,
S'ma nxore mallë.*

Poema “Kamadeva” përfundon me kujtimin e rrugës së vjetër, ku përkujtohet vendi i takimit me të dashurën, tani si një njeri më i pjekur që durimit të tij i ka ardhur fundi, sepse dëshira e tij është të bashkohet me të dashurën, tani përsëri në tokë e jo në qiell si në pjesën e dytë të poemës që e takon të dashurën në qiell, por as dashuria qiellore nuk e ngop, sepse njeriu si qenie, kërkon gjithmonë më shumë.

Lasgushi kishte një mendim – qëndrim shumë të drejtë për dashurinë. Ia kishte kuptuar fillin jetën e mbarimin/pafundësinë asaj. Prandaj, poezia e tij me motiv dashurie doli aq e arrirë, aq e lexuar dhe e vlerësuar nga djalëria e vajzëria shqiptare si dhe nga kritika e mirëfilltë letrare.⁸²

*O mall! O dashuri!
O yll! O djellë!
Sesi më djeg në gji,
Në zemër fellë!
Sesi më ndjell që larg,
Më ndrit përfare,
Me dritat varg e varg,
Vetetimtare.*

3.3. Mbi ta

Lasgush Poradeci ishte autori që ka shkruar për dashurinë dhe u identifikua më shumë si autori që poezinë e tij e përqendroi më tepër me temë dashurie dhe disa nga studiuesit e

⁸² Petraq Kolevica, “Lasgushi më ka thënë”. 8 Nëntori, Tiranë, 1992, f.71

poezisë së tij në kohën sa ai ishte gjallë dhe mbisundonte ideologjia socialiste e quajtën poet joatdhetar, poet që nuk ka shkruar mjaft poezi me motive patriotike, poet “pa ndërgjegje nacionale, pa kolorit nacional”, edhe pse pena e tij, thënë të vërtetën, kishte kapur figurat qendrore të historisë dhe të letërsisë shqiptare! Në të vërtetë poezitë e Lasgush Poradecit janë nga më patriotiket ndër poezitë e poetëve të mëdhenj në letrat shqipe, edhe pse ai nuk shkroi në stilin “O Atdheu im i dashur!”.

Ai nuk mburrë kurrë duke shkruar poezi në numër të shumtë me motive patriotike, sado edhe të tillat nuk i mungojnë, sepse Lasgushi më parë se lirik i motiveve të tjera, pra më parë se lirik i peizazheve, i lirikave mendimtare (filozofike) dhe i lirikave atdhetare, për nga shumësia e poezive, është lirik i dashurisë. Dhe kjo nuk e bën aspak poet joatdhetar. Përkundrazi, kur shkroi poezi me motive atdhetare, shkroi fuqishëm. Dhe më tej, gjuha e pastër shqipe e poezive të tij e jep poetin tonë të heshtur, ndër poetët më atdhetar që mund ta ketë poezia shqipe.

Poema “Mbi ta”, është poemë historike-epike, ku tema kryesore është kryengritja e Malësisë së Madhe dhe figurat historike, konkretisht në figurat e atdhetarit Dedë Gjo Luli dhe Mehmet Shpendi.

Në poemën e Lasgushit paraqitet trimëria e Dedë Gjok Lulit, udhëheqësit të shquar i Malësisë së Madhe në luftën çlirimtare kombëtare. Dedë Gjo Luli është personifikimi i maleve shqiptare, në kuptimin organizativ vetëmbrojtës, ushtarak dhe një orator i shkëlqyeshëm i fjalës.

Poema e Lasgush Poradecit fillon me përshkrimin e luftës së paepur të Malësisë së Madhe, kur trimëria e tyre krahasohet edhe me trimërinë e figurës sonë kombëtare Gjergj Kastriotit.

Malsija që bën sulm në zjarr

Po si dragoj me fletë

Siç bënte sulm ngadhërimtar

Gjergj Kastrioti vetë.

Lasgush Poradeci fuqishëm shkruan poemën e tij me ndjenjat e zjarrit për atdheun, siç shkruan fuqishëm edhe në poezitë e tjera të tij, sepse thellë në shpirt poeti është një lirik, që kujtudo që i këndon, i këndon me shpirt, e në këtë rast i këndon Malësisë së Madhe dhe trimave të saj, të cilët të bashkuar luftuan për të mbrojtur trojet e veta shumëshekullore.

Në poemë përshkruhet Malësia e bashkuar për mbrojtjen e trojeve etnike, kufijtë e tyre, me në krye me dy trima Dedë Gjo Luli dhe Mehmet Shpendin.

*U nismë shokë e miq
Prej Shkodrës në malsitë,
Ku Ded Gjo 'Luli me Deciq
Imbron atdheut kufitë
Përshkuam Tuz e Grudë e Hot
E Shalë dhe Tropojë,
Ku Mehmet Shpendi i gjindet zot
Atdheut në pararoje.*

Studiuesi i letërsisë shqipe Sabri Hamiti thotë se: “Interesimi i Lasgushit për të përmendur vende e data të rëndësishme të popullit, kombit të vet, nuk mund të jetë vetëm një interesim i romantikëve i bartur nga programi i tij; por vetëdije e zgjuar e një poeti në një kohë, sepse kështu do të vazhdojë të këndojë poezia shqipe edhe mbas Lasgushit. Kjo mund të provohet më së miri me interesimin e Lasgushit për historinë: duke futur në tekstet e veta poetike Skënderbeun, Ismail Qemalin, Naimin, Asdrenin, poeti do të bëjë një udhëtim imagjativ nëpër të kaluarën e shqiptarëve duke u revoltuar në një faqe të kësaj historie.⁸³ Pikërisht në poemën “Mbi ta”, autori përmend vende e ngjarje të vërteta, historike, persona të vërtetë, vende të vërteta siç janë “Drini”, “Shëndaumi”, etj.

Autori në këtë poemë shpreh vrullin e dëshirën e malësorëve për të mbrojtur trojet etnike. Kryengritja e malësorëve për të mbrojtur trojet e tokat etnike me gjakun e tyre, si dëshmi se shqiptarit nuk i dhimbset as jeta për të mbrojtur vendin e tyre, për t’u dëshmuar se për atdhe nuk iu dhimbset as jeta.

*Mes Arbërit, me mall rinor,
E zbret kalitas drumi,
Ku Drini plak e përrallor
Buron prej Shëndaumi*

*Mirë se të gjejmë atdhe bujar!
Malësi e lavdëruar!*

⁸³ Sabri Hamiti, “Lasgushi qindvjeçar”, Prishtinë, 1999, f.33.

Pranon ti, oh! Pak gjak shqiptar

Që vjen për t'u dëshmuar

Aq bukur thuren vargjet për luftën e trimave shqiptarë duke luftuar për të mposhtur armikun turk e për të mbrojtur kullat e tyre, sa që rrënqethesh kur autori me figurën e krahasimit përshkruan se si luftuan të gjithë duke mos u kursyer duke filluar nga çunakët shtatëvjeçar e deri te pleqtë qindvjeçar.

Dy figurat e pashallarëve Shefqet Pashai e Bedri Pashai, shfaqen si dy figura të urreyera të cilët vijnë për të pushtuar Lumen, Mirditën, Dukagjinin, Shalën, Hotin e Shkodrën për të shpërndarë dhunë e çarmatim, e për shqiptarin çarmatim është më e vështirë se vdekja, jeta e tillë nuk pranohet.

Këndonte djaloshi i lum

Me delet n'ato shpate,

I shfryu turqeliu-dumdum:

“He! Jep at ‘armen tate!”

Po shpejt bariu qëllon e shtje,

Përmbys përposh barbarin:

Ja shpje Sulltanit për meze,

Kush çarmatos Shqiptarin

Autori tregon se shqiptarët për të luftuar kundër armiqve shumë shekullor nuk iu dhimbset jeta dhe lumjanët këtë e bëjnë si të ishin në dasmë e jo në luftë, e më pastaj shfaqet vleri e inati i Pashait i cili ishte në krye të katër ushrive e dyzetmijë ushtarëve, të cilët duan që të parët ta pushtojnë Lumën, mirëpo edhe pse ka disporporcion të numrit të ushtarëve, me ndjenjën e tradhtisë në zemër, dëshirojnë tinëzisht ta pushtojnë Lumën. Mirëpo autori me figurën e hiperbolës i pasqyron shqiptarët me zemër të madhe që luftojnë të paepur duke mposhtur armikun edhe pse në numër ishin shumë pak.⁸⁴

Dhe prap sulm: “Mbi ta! mbi ta!”

Mbi mijëra e tjera,

Iu shtir përmendsh te ziut pasha

Sikur vërshoj sketerra.

⁸⁴ Mirlinda Krifca, “Dialog me poezinë e Lasgush Poradecit”. Shkup, 2000, f.198

Dh'ish një përleshje e mbytje e mort

E briterm e tmerruar,

U mbraps pashaj, i tundur fort,

Me ushtarët e gjysmuar.

Poema “Mbi ta” e Lasgush Poradecit, paraqet luftën e paepur të popullit shqiptar, me vetë titullin shihet qartë se ku aludon autori, se populli shqiptar do të jetë gjithmonë mbi, gjithmonë do të sulmojë të parët, gjithmonë do të fitojnë dhe gjithmonë armiqtë do të zmbropsen të turpëruar, siç bëjnë edhe personazhet e poemës, Shefqet Pashai dhe Bedri Pashai.

Malësorët me trimërinë e tyre, shkojnë me vullnet e krenari për të mbrojtur atdheun e tyre bujar, krenar me vendin dhe me vetën, trima që s’iu trembët syri, shkojnë në luftë jo vetëm për të mposhtur armikun, por edhe për t’u dëshmuar para atdheut, kombit, fisit e sigurisht edhe historisë, sepse për malësorin jeta nën thundrën e armikut nuk është jetë, dicka që nuk mund të paramendohet dhe ata luftojnë për t’u dëshmuar atdheut, për të fituar lavdi, e për të mos u harruar kurrë.

Mirë se të gjejmë atdhe bujar!

Malësi e lavdëruar!

Pranon ti, oh! Pak gjak shqiptar

Që vjen për t’u dëshmuar.

Për t’u mbuluar me lavdi

Në sulmet fitimtare,

Të bëhet fli, ku bëhen fli

Heronjë të shqipëtarë

Në poemën “Mbi ta”, autori i thur lavde popullit shqiptar. Ai paraqitet i bashkuar, trim, bujar, miqësor, që nuk trembet as nga ushtritë me dyzetmijë ushtarë, të armatosur rëndë, sepse zemra e shqiptarit, besa tij është më e madhe, aty luftojnë të gjithë pa dallim moshe, që nga plaku qindvjeçar deri te çunaku shtatëvjeçar, luftojnë me shpirt për të mbrojtur tokat e atdheut, në krye të tyre gjithmonë janë figurat e vërteta historike si Dedë Gjo Luli e Mehmet Shpendi, andaj shqiptarët e Malësisë së Madhe kanë një mesazh për Sulltanin, se shqiptarët

nuk duan mbret për të sunduar dhe dy pashallarët e sulltanit kthehen të turpëruar nga trojet shqiptare.

Poema “Mbi ta” është poemë mbi historinë e shqiptarëve, duke krijuar përmes saj të kaluarën e lavdishme të shqiptarëve, të Malësisë së Madhe dhe trimave të saj, e cila përmbillet me mposhtjen e armikut, pashallarëve të cilët kthehen të turpëruar te Sulltani i tyre, të cilët me qëllim të shfajësimit para tij i hiperbolizojnë figurat e trimave të Malësisë së Madhe, Dedë Gjo Luli e Mehmet Shpendi.

*“Me faj e turp, Sulltan-Baba,
Po kthehem i ngarkuar,
Se Mehmet Shpendi ish katalla,
S’do mbret për ta sunduar;*

*As Ded Gjo ‘Luli s’do në Hot
Mbi krepat tmerrimtare,
Ku as shqiponjat s’ngjiten dot,
Veq djajtë shqiptarë;*

*Dh’as Luma s’të le ndër aspak
Që të sulmosh i pari:
M’i pari, thotë, ku rrjedhe gjak,
Sulmon vetëm shqiptari;*

3.4. Poemat e Lasgushit dhe situatat e kuptimet në këto tekste

Si liriku më i madh shqiptar, ka ofruar poezitë ndër më të realizuarat në letërsinë shqipe. Temat dhe idetë e tij madhore janë të shfaqura nëpërmjet një arti poetik, gjithashtu madhështor. Ky poet gjenial duke dashur të gjejë vetën në botën e letërsisë shqipe u bë njëri nga krijuesit më të mëdhenj të saj, duke shkruar poezi që shprehin botën shqiptare me rikrijimet e veta origjinale shpeshherë duke u mbështetur edhe në figura popullore dhe kështu duke e përforcuar mendimin, se ai është poeti dhe liriku më i madh i shekullit të vet.⁸⁵

⁸⁵ Mirlinda Krifca, “Dialog me poezinë e Lasgush Poradecit”. Shkup, 2000, f.27.

Poezitë e Lasgushit quhen nga të gjithë shumë realiste dhe të vërteta. Kjo gjë ndodh, sepse ai hidhte në letër çdo gjë që ai ndiente në çdo periudhë. Me Lasgush Poradecin ndodh, në fakt, një modifikim struktural në retorikën e poezisë shqipe. Poezia e Lasgush Poradecit është njëkohësisht edhe filozofike dhe me një fjalë më ndryshe nga të tjerët, i nxjerr vështirësi jo vetëm lexuesit të zakonshëm, lexuesit të thjeshtë, por edhe studiuesit të saj, në këtë rast lasgushjan. Ndërkaq poezia filozofike (mendimtare) i bën ballë kohërave, sepse edhe interpretimet për të janë shumë herë të pathëna pothuajse kurrë në mënyrë të shterrueshme dhe të kënaqshme.

Figurat poetike që i ndërton Lasgushi shquhen për origjinalitetin e tyre, për nivelin e lartë artistik dhe për harmoninë e duhur me përmbajtjen dhe formën e veprës së tij.

Shihet qartë se ky autor i ka kushtuar rëndësi të madhe artikullimit gjuhësor të shprehjeve poetike.

Gjithë krijimi poetik i Lasgushit, është krijim origjinal me vlerë të madhe dhe kjo vërteton që poeti ka punuar shumë që të ketë një sistem unikat poetik e të pavarur pa ndikime të jashtme dhe pa iu nënshtruar askujt dhe ku mund të thuhet se i gjithë ky sistem është një krijim i liruar nga ideologjia e kohës.

Talentit të tij të pakundërshtueshëm në poezi, Lasgushi diti t'i bashkangjisë një punë të madhe e të mundimshme për shumë vite, duke u ballafaquar edhe me pushtetin i cili nuk e përkrahu, sepse asnjëherë nuk i shërbeu për të himnizuar ideologjinë e tyre letrare. Ishte imagjinata e lindur e autorit dhe pasioni i ndezur që u fuqizua nga kultura e gjerë e tij dhe arti popullor. Pikërisht këtu më duket se qëndron shkaku i një qëndrese kaq të sigurt të veprës së tij ndaj kohës, sepse edhe sot po ta lexosh veprën e tij askush nuk mund ta konteston se para vetën ke një vepër që të lë një mbresë të pashlyeshme. E tillë është edhe poema e tij alegorike-etike “Eskursioni teologjik i Sokratit”, me ëndje lexohet edhe sot, siç lexohet e gjithë vepra e tij, sepse është origjinale dhe e figurshme.

Alegoria si figurë shfaqet në tërësi në poemën “Eskursioni teologjik i Sokratit”, Sokrati si figurë shfaqet si një personalitet i zoti, i shkolluar, inteligjent që kërkon drejtësi dhe të vërteta në një vend ku sundon gënjeshtria, mashtrimi e intriga, kërkon të zbulon të vërtetën popullit të vuajtur dhe po të shikosh nga figura e alegorisë, kupton se Sokrati në të vërtetë është autori dhe jo filozofi grek, poeti kundërshton pushtetin, ideologjinë e cila mbretëronte në atë kohë në Shqipëri. Stili Lasgushian, dikur me tone romantike, tani në poemën

“Ekskursioni teologjik i Sokratit” merr ngjyra kritike dhe ironie, por edhe alegorie për shoqërinë totalitare të kohës por poezia nuk e humbet as natyrshmërinë, as spontanitetin.

E gjithë vepra poetike e Lasgush Poradecit shënon kufirin ndarës me poezinë e mëparshme, sepse me shkrimin poetik të tij realizohen themelet për shkrimin e poezisë; - sendërtohet statusi i poezisë/art, më përtej dobësisë dhe shërbesës diturake, atdhetare dhe sociale, pra shfaqet poezia arti i pastër, madje edhe kur këndon për atdhe dhe moral; - realizohet statusi i poetit krijues i letrarës, pra duke lënë pas shpine detyrimet e tjera të misionit atdhetar, fetar, social dhe moral dhe poeti, tashmë ka si mision që të realizojë poezi të fuqishme vetëm si shenjë letrare. Deri tek Lasgush Poradeci, mjerisht edhe mbas tij, sidomos poezia e shërbesës socrealiste, e kemi parë letërsinë dhe poezinë shqipe se si ka lënguar edhe prej detyrimeve jashtëletrare, të pashmangshme për rrethanat dhe kontekstet. Vargjet mbajnë gjithnjë vec figuracionit të pasur edhe një tingëllim origjinal, gjë që përfitohet dhe më shumë nga efekte akustike që japin anafora, epanostrofeja, aliteracioni, përsëritja poetike, dhe gjithë sintaksa poetike e vjershërimit lasgushian.⁸⁶

Ndërsa, kur jemi te dy poemat e tjera të Lasgushit “Kamadeva” dhe “Mbi ta”, që të dy poemat kanë veçantitë e tyre, e para me temë dashurie, ku poeti me një shije të hollë e të veçantë paraqet situata e kuptime interesante, ku poema shkruhet me një lirizëm personal dhe ku dashuria shpaloset si një ndjesi apo esencë e jetës e cila përjetohet thellë nga personazhet, e cila dashuri në pjesën e dytë të poemës paraqitet edhe si dashuri që kalon hapësirat qiellore për të provuar fuqinë e zjarrin e pashuar. Dashuria si ndjesi që herë të demoralizon me ndarjen e herë të ngritë në qiell me bashkimin e të dashurve, të cilët për të qenë bashkë kalojnë hapësirat qiellore e ato tokësore për të gëzuar dashurinë e tyre.

Poema “Kamadeva” është një ndër shkrimet e fundit të autorit, gjë që dëshmon se autori dashurinë e ka shkruar si në rini, ashtu edhe në pleqësi, sepse thellë në shpirt i ka fjetur tema me motiv personal, pra të dashurisë.

Po të shikohet me kujdes, në të gjitha poezitë dashurore të Lasgushit nuk kemi të bëjmë me një person që i këndon thjesht dashurisë, por gjithnjë i referohet çiftit, d.m.th krijimit të një jete të ardhme, familjes së re, sepse pa këto elemente, të dashurisë, të çiftit dhe të familjes nuk mund të krijohet jeta. Dashuria është ndjenjë që pushton zemrën e që autori nuk e shkruan si një ndjenjë të thjeshtë, por si një ndjesi të thellë apo esencë jetësore.

⁸⁶ Mirlinda Krifca, “Dialog me poezinë e Lasgush Poradecit”. Shkup, 2000, f.17.

Poema “Mbi ta”, me temë historiko-epike e shkruar po ashtu në fund të krijimtarisë së autori, thuhej se Lasgushi shumëherë në takime të ndryshme me miq e recitonte me një dëshirë e vulnet të madh të tërën, sepse kjo poezi nuk kishte për temë trimat e Malësisë së Madhe që ishin krenaria e kombit shqiptar. Ndërsa në anën tjetër nuk ka recituar poemën “Ekskursioni teologjik i Sokratit”, sepse me shkrimin e kësaj poeme kishte dashur të zbulojë një realitet të hidhur që mbretëronte në atë kohë në Shqipëri.

Posa të lexohet poema “Mbi ta”, shfaqet dëshira e autorit që të paraqesë historinë e lavdishme të popullit shqiptar, luftërat e paepura të Malësisë së Madhe, Lumës, Mirditës, Dukagjinit, Shalës, Hotit e Shkodrës. Edhe pse poeti nuk njihet si poet himnizues, mirëpo poema e tij për nga forma nuk ngjason me veprat e romantizmit të cilat ishin të varfëra për nga figura. Ndërsa lexuesit e veprës së Lasgushit, që në fillim të leximit të poezive të tij, ndeshen me ato fjalë të reja, për të mos thënë të papritura dhe jo të zakonshme, të përdorura pothuajse vetëm nga Lasgushi apo shumë-shumë rrallë nga të tjerët.

Fryma moderne në poezinë e Poradecit është në frymë, në atmosferë që krijon, në mendim dhe mesazhe, por edhe në rigjallërimin e aftësive të shqipes së hershme për të kumtuar dhe kumbuar art. Edhe tri poemat e Lasgushit që janë pjesë e këtij punimi shkencor janë të një niveli të tillë, kanë frymë moderne e cila ndihet në atmosferën që krijon, në mendim dhe mesazhe, por edhe në rigjallërimin e aftësive të shqipes së hershme për të kumtuar dhe kumbuar art. Sepse, të tri poemat janë krijuar atëherë kur poeti kishte ndërtuar sistemin e vet poetik, e kishte përsosur këtë, e kishte menduar mirë çdo shkrim të tij dhe me një fjalë kishte ardhur duke përsosur këtë. Ai në të tri poemat përdor një shkrim të figurshëm, që situatat dhe kuptimet të kuptohen përmes këtyre figurave.⁸⁷

3.4.1. Poemat si mesazh kuptimi

Leximi formalist i poezisë së poetit, duke synuar që të artikulohet tipari më thelbor i shkrimit poetik, fryma moderne, ndonëse edhe në këtë aspekt, shumica e shqyrtuesve të poezisë së Poradecit, ende kanë mbetur në shenjim adhurues të poetikës së tij, si thelbësisht moderne, si dhe natyrën e vërtetë të tipareve moderne të shkrimit poetik lasgushian, pra duke shpërfillur faktin se mënyra e thënies, sido që të jetë forma e shprehësisë, shpalos ide dhe mesazhe të qarta, së paku kështu ngjet me poezinë e Poradecit. Ai hyn në poetët më të qartë dhe më të

⁸⁷ Sabri Hamiti, “Letërsia moderne” – Vepra letrare. Prishtinë - Faik Konica, 2002, f.187

kuptueshëm të letrave shqipe të shekullit XX e këndej, ndonëse edhe shenjat e artit janë edhe më të fuqishme në materien poetike të sendërtuar prej tij.

Lasgushi mbetet me një zë tejet origjinal me gjithë poezinë shqipe, poezia e të cilit pasuroi me ide, teknika poetike, forma e prosede krijuese, me fjalë e me mendime shpirtin e kombit të vet. Lasgushi nuk e ndan poezinë në mënyrë skematike sipas motiveve dhe temave kryesore, por e ndan në bazë të frymëzimit të momentit dhe të konceptimin që ai ka.

Leximi i veprës së Lasgushit, pavarësisht nga opinionet dhe vlerësimet e kritikës, ka qenë i gjithëkohshëm, sepse kjo poezi i referohet thelbit njerëzor, botës diskrete të njeriut, intimitetit, ëndrrës, dashurisë, koshiencës dhe subkoshiencës, misterit dhe fshehtësisë, pranisë së Zotit, natyrës – bukurisë së përjetshme të natyrës.⁸⁸

Dashuria, kjo temë e përjetshme në veprën e Lasgushit, projektohet në dy rrafshe kuptimi: në një anë si ndjenjë humanizuese, si frymë lëvizëse e jetës dhe në anën tjetër dashuria si fuqi e afrimit të (djalit me vajzën) siç është rasti edhe në poemën “Kamadeva”. Tek poema “Kamadeva” tema e dashurisë, por edhe te temat e tjera Lasgushi përdor figurat e hapësirës (largësi pakufi), figurat e kohës pakufi (përjetësia), siç është rasti kur vajza e djali ndahen dhe për t’u takuar sërish kalojnë hapësira pakufi në qiell, mirëpo as kjo dashuri nuk e kënaqë dhe zbret prapë në tokë, për të vazhduar dashurinë e tyre.

Pra, dashuria në poezinë e Lasgushit këndohet si një plagë që për të mbetur gjallë përditë e do nga një lëndim të ri, (dashuror).

Dhe tretur Dashuri

Përposh në fare!

Ah, shkrirë, o Dashuri,

Përvëlimtare.

Lasgushi me poezitë e tij deshi të ishte unikat, vargjet e tij të buronin nga shpirti i tij, siç ishin edhe vargjet në poemën “Kamadeva”, ku edhe këtu me një lirizëm të thellë i këndon vashës (gruas), i këndon edhe përtej botës me një dashuri imagjinare e thurur edhe me emërtime popullore siç e quan edhe vashën, shtat-hedhura-selvi etj.

Edhe poema tjetër e Lasgushit “Eskursionit teologjik i Sokratit” me temë alegoriko-etike të cilën po ta analizosh në rrafshe kuptimi, vërehet se poeti përdor figurën e alegorisë për të

⁸⁸ Mirlinda Krifca, “Dialog me poezinë e Lasgush Poradecit”. Shkup, 2000, f. 55

fshehur kuptimin e vërtetë që ishte të përqeshte pushtetin e asaj kohe në Shqipëri, nuk i pëlqente një ndryshim i thellë politik?! Njerëzit e pushtetit e akuzonin se nuk kishte frymëzim që për të shkruar, por nuk ishte se Lasgushit i mungonte frymëzimi, por ishte çështja e ndryshimit të politikës, e cila diktonte se si të shkruhej letërsia! Mirëpo arsyeja kryesore ishte se Lasgushi nuk shkruan ashtu si nuk shkruhet poezia. me diktat, poezi të angazhuar, poezi edukuese, poezi që nuk ta kënaqë shpirtin, pra siç thoshin –poezi që edukon apo sociale, himnizuese.⁸⁹

Poezinë e angazhuar dhe edukuesi Lasgushi nuk e shkroi, andaj e shkroi poemën “Ekskursioni teologjik i Sokratit”, pikërisht për të kundërshtuar këtë politikë që nuk diti të çmojë artin e poezisë së vërtetë. Ai e kuptoi poezinë më ndryshe, më larg së qeni poezi edukuese. Tek “Ekskursioni teologjik i Sokratit”, shkrimi i autorit është i bazuar në figurën e alegorisë, e cila figurë të bënë për të kuptuar se edhe pse paraqitet situata në kohën antike, atëherë kur edhe ka jetuar filozofi grek edhe lexuesi kupton se poeti në fakt, përmes figurës së alegorisë, fsheh realitetin politik në Shqipëri.

Kur jemi te poema “Mbi ta”, e cila ka si temë kryesore historinë e luftërave të Malësisë së Madhe, trimërisë dhe luftës së paepur të trimave të këtyre anëve, edhe këtu Lasgushi shkruan me një përkushtim të madh një realitet të ndodhur, sepse në fakt shkruan një poemë me temë historike, ku flet për një realitet të ndodhur me të vërtetë, shkruan për personazhe reale historike dhe flet për një kohë të shkuar, siç ishin luftërat dhe trimëritë e Dedë Gjo Lulit dhe Mehmet Shpendit. Mirëpo edhe në këtë poemë nuk e humbë figurshmërinë e shkrimit të tij, përkushtimin e tij në formën e poezisë dhe kujdesin për çdo fjalë të shkruar. E gjithë poema “Mbi ta” është shkruar duke përputhur rima dhe sikur me këtë poemë autori ka dashur që të ngrit moralin e shqiptarëve me të kaluarën e lavdishme të popullit shqiptar dhe vetë me një rast thotë se rima është kryesore në poezi, sepse poezia e rimuar të tërheq më tepër vëmendjen.

Që në fillim të poemës “Mbi ta” shihet se autori përdor rimën, kompozicionin duke dashur që t’i japë një ngritje apo vlerësim të madh luftës së trimave të Malësisë, të cilët luftojnë edhe me mauzer edhe me pendë. Me këtë autori do të japë një mesazh kuptimi se shqiptarët nuk kanë qenë trima vetëm në luftë, por edhe të aftë e të zotë edhe në pendë, e kur bashkohen të dyja këto cilësi, çdo armik mposhtet, e me këtë dëshmohet edhe trimëria e kombit shqiptar. Në poemë përshkruhen edhe zonat gjeografike të trojeve shqiptare, ku luftuan dy udhëheqësit

⁸⁹ Sabri Hamiti, “Letërsia moderne” – Vepra letrare. Prishtinë - Faik Konica, 2002, f.173

e luftërave të Malësisë Madhe, Dedë Gjo Luli dhe Mehmet Shpendi, të cilët autori i ngritë në piadestalin më të lartë për trimëri, duke dashur të japë një mesazh kuptimi se poema “Mbita”, bazohet në historinë reale të popullit shqiptar.

*Shpejt me mauzerin tënd zemrak
Dhe pendën e praruar,
Ku mposht halldupin turkoshak
Atdheu duke u dëshmuar.*

*Në Hot e Grudë e Traboin
Puth Ded Gjo ‘Lul viganin,
Mirditë e Shalë e Dukagjin
Puth Mehmet Shpend Luanin.*

3.4.2. Poemat dhe figurat elementare

Lasgushi mbetet njëri ndër autorët më të figurshëm në letërsinë shqipe. Poezia e pastër e kulluar dhe gjuha e zjarrtë e me plotë figura, që buron nga thellësia e shpirtit lasgushian, bën për vete secilin lexues e adhurues të poezisë e të artit. Edhe pse mund të duket si një këngë lavdie e përsosmërie, që vjen nga qielli dhe amshimi. Aq bukur i këndoi dashurisë, sa që edhe çdo kush që e dëgjon lidhet me të dhe e ndien thellë.

Lasgush Poradeci shkroi pak, për të treguar se poezitë e tilla edhe pse në një numër jo të madh, për nga rëndësia kanë vlerë të madhe, sepse jetojnë, mbesin ndër brezni, ushtojnë si bubullimë qielli, mbesin si margaritarë që mendjet dhe zemrat tona njerëzore i shqetësojnë dhe i qetësojnë në vazhdimësi dhe në çdo brezni. Ndoshta dy libra do t’i dukeshin pak gjithkujt për një poet gjenial si ai, por ai vetë si Lasgush ishte i mendimit që një poeti gjenial i mjaftojnë vetëm dy libra me poezi dhe asnjë më tepër.⁹⁰

I bindur për bukurinë e poezive të tij, gjë të cilën nuk e vuri kurrë në dyshim, ato janë poezi të shkruara dhe të rishkruara, të përpunuara disa herë. Kjo mënyrë pune vërehet tek libri “Ylli i Zembrës”, ku disa poezi gjenden në disa variante, si dhe mund të shihet një faksimile e

⁹⁰ Sabri Hamiti, “Lasgush Poradeci – Vdekja e Nositet”. Prishtinë, Rilindja, 1986, f.39

dorëshkrimit të poezisë “Naim Frashërit”, ku dallohet qartë se ajo është përpunuar shumë herë nga prishjet dhe vizat që ka bërë.⁹¹

Poradeci është quajtur me të drejtë si poet i natyrës dhe dashurisë, por edhe është harruar me pa të drejtë se Poradeci ka shkruar poezi kaq të fuqishme edhe për gjuhën, kombin shqiptar, qenien njerëzore si univers, por edhe poezi të natyrës së pastër filozofike. E tillë është edhe poema e tij etiko-alegorike “Ekskursioni teologjik i Sokratit”.

Lasgushi mbetet një personalitet dhe poet i ndjeshëm, me një njohuri për botën që e rrethon, ngjarjet, një personalitet me karakter të fortë që nuk bie asnjëherë nga sfidat jetësore, e këtë më së miri e paraqet edhe në poezitë e tij, e sidomos kjo vërehet edhe në poemën “Ekskursioni teologjik i Sokratit”, e cila është një poemë që shkruhet totalisht nën ndikimin e figurës së alegorisë, ironisë, ku shihet se autori nuk kishte qëllim të paraqiste antikitetin grek, por realisht kohën e Shqipërisë kur u shkrua poema. Kjo alegori e ironi në fakt shkruhet me qëllim të kundërshtimit të kohës dhe rrethanave kur jetonte autori, sepse autori ishte i anashkalluar nga pushteti, nga kritika e kohës, sepse ai nuk shkroi vepra himnizuese për këtë shoqëri, kështu që Lasgushi preferoi të rrinte i mbyllur dhe i heshtur, të mos botonte fare vepra dhe në një far mënyre kështu me këtë indiferencë të refuzonte dhe të ndëshkonte këtë shoqëri që nuk e çmonte ashtu si e meritonte me të vërtetë ai, me këtë heshtje apo tërheqja nga botimet ishte njëfarë forme si ndëshkim për pushtetin apo të themi një refuzim nga ai.

Një shkrim mjaft i figurshëm është edhe poema me temë të dashurisë “Kamadeva”, ku Lasgushi i këndon dashurisë, si një ndjenjë e thellë që e përcjellë gjatë gjithë jetës së tij, si një ndjenjë që e beson dhe që e trondit njëkohësisht. Te ato tingëllon i veçantë zëri i tij, figuracioni origjinal dhe variantet e ndryshme të ndjenjës së thellë, sepse pikërisht në këtë temë e gjeti vetën më së miri poeti, ku la pas vetës poezi e poema brilante.

Në poemën “Kamadeva” autori i këndon dashurisë me ndjenjën e thellë për vashën e cila e kthen këtë dashuri me po aq ndjenja si autori. Edhe në poemën “Kamadeva” vërehet se autori në përshkrimin e vashës është mbështetur te figurat popullore siç del edhe në poezitë lirike të tjera të tij, siç janë fjalët gojëplotë, krum-holla, shtat-hedhura-selvi, llëre-kulluar etj.

Pa gojë, o zemër ti,

Kjo fjala jote!

Pa fjalë, o dashuri,

⁹¹ Sabri Hamiti, “Letërsia moderne” – Vepra letrare. Prishtinë - Faik Konica, 2002, f.212

O gojëplotë!

Në poemën epiko-historike të Lasgush Poradecit “Mbi ta” përfshihet një shkrim mjaft i figurshëm. Vetë dy figurat qendrore të kësaj poeme janë dy figurat historike Dedë Gjo Luli e Mehmet Shpendi të cilët përshkruhen si dy trima me fuqi të mbinatyrshme dhe ku kemi të bëjmë me paraqitjen e figurave të hiperbolës dhe krahasimit.⁹²

Figura e krahasimit vërehet qartë kur krahasohen trimat me dragonjtë, ndërsa ajo e hiperbolës kur Mehmet Shpendi ka fuqi mbinatyrore dhe prej gjylet njëqind okë.

*“Nuk lidhet Ded Gjo ‘Luli i math
Dragua fis prej fisi,
Të kap si berr, të ther ‘në vath
Të var në degë lisi.”*

*“Nuk lidhet Shpendi lart në Theth,
Pret gjylet njëqind okë,
I pret mbi sup e prap t’i hedh,
Sulltan jezit, mbi kokë.”*

3.5. Tema në poemat e Lasgush Poradecit

3.5.1. Poemat me temë alegorike-etike

Ndonëse tema qendrore e poezive të Lasgushit është ajo e dashurisë, ky autor i përmasave botërore, vjen me artikulumin e veçantë artistik për të ofruar imazhin e të bukurës, dashurisë, vashës, gruas, për të dhënë peshën e dashurisë si një esencë jetës dhe e ekzistencës së njeriut. Ai mbetet një ikonë sidomos me poemën e tij “Ekskursioni teologjik i Sokratit”, e cila është një poemë e cila shkruhet nën ndikimin e figurës së alegorisë. Kjo alegori shkruhet si kundërshtim i autorit për refuzimin që i bënte shoqëria e kohës, sepse ai nuk shkroi vepra që do të ngriste në qiell pushtetin e atëhershëm, për t’i bërë qefin dikujt, punën e tij e përfundoi në heshtje pavarësisht a çmohet dhe përkrahet vepra e tij, sepse ë atë kohë përkrahnin doktrinën e saj. Lasgush Poradeci donte që poezia e tij të kishte strukturë e poezi që do të kalonte brezat e nuk do të shuhej dhe do të mbetej ikonë në letërsinë kombëtare shqiptare.

⁹² Kujtim M. Shala, “Lashgushi i përjetshëm”. Faik Konica – Prishtinë, 1999, f.32.

Poema “Ekskursioni teologjik i Sokratit”, është një alegori e pastër, një alegori kundër shoqërisë apo diktaturës totalitare përmes personazheve të poemës, kryepriiftit, kryegjyqtarit dhe kryepushtetarit, të cilët manipulonin popullin e paditur.

Lasgushi për injorancën dhe besimin e kotë, fajin e hedh te populli, sepse besojnë në mashtrimin e pushtetarëve, pra besojnë në sistemin dhe idetë e tij.

*Nuk ka zeus, as nuk ka Zot
Ferr lugat t’imagjinuar
Po ka popull të paditur
Popull q’ende s’është zgjuar.*

Sokrati mundohet ta zgjojë vetëdijen e popullit, për të kuptuar se është i gënjyer, i mashtruar nga ky realitet shoqëror.

Botëkuptimi i tij është idealist dhe kjo lë gjurmë sado të vogla, atëherë kur ai i këndon me ëmbëlsi vashës dhe natyrës shqiptare, por edhe atëherë kur ironizon me realitetin aktual përmes figurës së alegorisë që është e pranishme sidomos në poemën “Ekskursioni teologjik i Sokratit”. Shpeshherë Lasgushi i largohet realitetit, sepse kishte një pakënaqësi ndaj tij dhe vetë poema është e shkruar në formën e kërkimit të së vërtetës shoqërore. Edhe Sokrati i poemës bëhet Sokrat i tekstit letrar – figurë personale. Gjithë këtë e kupton pasi tekstin e lexon përmes figurës së alegorisë, sepse thellë në thelb, kjo është esenca e shkrimit të Lasgushit, që përmes figurës së personazhit moral që është Sokrati, të prek aktualitetin e kohës në Shqipëri, që ishte ideologjia socialiste. Ky sistem shprehet përmes figurave tekstore si: kryepriifti, kryepushtetari, kryegjyqtari, si tre personazhe që luajnë rolet kryesore në krye të pushtetit manipulues dhe në anën tjetër është populli dhe Sokrati si pjesë e popullit që mundohet t’iu sqarojë se nuk duhet besuar këtyre të parëve dhe mundohet të pasqyrojë gjendjen reale të kohës.⁹³

Është dëshmuar se vendet kanë nevojë për Sokratë, që të ndriçohen dhe të tregojnë se populli është i gënjyer, e këtë Lasgushi e vërteton përmes figurës së alegorisë, duke dëshmuar kështu se besimi i popullit në tri shkallët e para të pushtetit nuk është tjetër vetëm një mashtrim i tij dhe këtë e argumenton Sokrati. Mirëpo edhe populli fillon të kuptojë në fund farsën e udhëheqësve dhe me anë të ironisë kundërshtuese dhe me një pikë vërehet kjo:

⁹³ Sabri Hamiti, “Letërsia moderne” – Vepra letrare. Prishtinë - Faik Konica, 2002, f.189

*Foli e tha: O filozof,
Filozof Sokrat me nam,
Unë besoj me gjithë zemër,
Si i paditur që jam.*

Sokrati kupton mashtrimin e tre pushtetarëve dhe dënimi për zbulimin e tij është dënimi me vdekje ku edhe helmohet për shkak të kërkimit të tij të ndaluar. Populli i mashtruar beson në pushtetarët, nuk beson në Sokratin që mundohet të shpalosë të vërtetën, sepse dëshira e Sokratit është që populli të vetëdijesohet nga ky mashtrim, sepse populli mund të rreñojë një sistem grabitës e mashtrues. Prandaj, zbulimi i këtij realiteti është ideja e figurës së Sokratit, të zbulojë edhe të vërtetën e realitetit që mbretëronte në atë kohë.

Sokrati, heroi moral i Lasgush Poradecit që në rini, mbetet heroi i tij moral gjatë gjithë jetës së tij dhe që shfaqet edhe në pleqëri në poemën e tij të pleqërisë: “Ekskursioni teologjik i Sokratit” dhe mund të konkludojmë se vetë figura e Sokratit është vetë brendia e personalitetit të autorit, i cili e di të vërtetën se populli është i mashtruar nga rendi mashtrues që udhëhiqte vendin dhe një Lasgush i vetëm nuk mund t’i vetëdijesonte popullin që po besonin kot një ideologji të tillë, sepse ata ishin të mashtruar nga pushtetarët, ashtu si mundohet edhe Sokrati i antikitetit të vetëdijesojë popullin për mashtrimet e bëra nga tre prijësit e pushtetit.

Është evidente se Lasgush Poradeci ishte një lirik i cili poezinë e vet e shkruan duke mbështetur në unin e tij personal, në atë se çfarë ndien. Figurat poetike brenda veprës kanë arritur efektin e tyre të natyrshëm në ndërtimin e imazhit poetik, brenda esencës poetike në poemat e trajtuara. Si të tilla ato të zgjojnë ndjenjën e së bukurës artistike.⁹⁴

Lasgushi siç e kemi cekur më lart mbetet njëri ndër poetët që i pari përdori shkrimin e figurshëm, ai i dha një rëndësi jo të zakonshme fletës poetike, anës grafike e vizuale të saj, këto ishin ambiciet e poetit për të realizuar një vepër të madhe me cilësi të gjuhës poetike, stilit dhe figuracionit, të cilat janë elementet kryesore për ta bërë një vepër artistike.

⁹⁴ Sabri Hamiti, “Lasgush Poradeci – Vdekja e Nositet”. Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 74.

3.5.2. Tema e dashurisë

Kur jemi te tema e dashurisë që është temë kryesore jo vetëm në poemën “Kamadeva”, por është temë qendrore edhe në disa nga poezitë më të spikatura të Lasgushit dhe padyshim si objekt studimi është poema e pleqërisë së poetit “Kamadeva”. Tema e dashurisë të cilën autori e ndien, e këndon dhe e kupton më së miri. Poema “Kamadeva” është poemë ku spikatet një emocion i thellë lirik, sepse siç e dimë lirika frymëzohet nga thellësia e emocionit apo brendësia e vetë autorit që në këtë rast bëhet një me autorin.⁹⁵

Në këtë temë Lasgushi e ka shkrirë vetën, e ka thënë më shumë, ndoshta më shumë se të tjerët, atë që duhej thënë për dashurinë. Ka shkruar thellë për dashurinë, sepse edhe ka pasur një kuptim e qëndrim të drejtë e të çiltër për të. Pra, vetë autori është personazhi i poemës dhe ndjenjat që shprehën janë ndjenjat e vetë autorit, sepse vetë lirizmi është transformim i ndjenjës së tij në poezi dhe për të kuptuar atë duhet që ta ndjesh, ta lexosh drejtpërdrejt.

Në poemën e Lasgushit vërehet edhe figura e metaforës kur Lasgushi vashën e quan O motra ime dhe këtu nuk është se autori vashën e ndjen si motër, por metaforikisht e thërret me këtë emër, duke dashur që figurën e vashës ta ngritë lartë, sepse në lashtësi ky ka qenë emërim i vashës, gruas që mban gjallë botën dhe vazhdimësinë e jetës.

*...Kur je q'ashtu me ndjell
Me ato kujtime,
Me ngreh përdrejt në qiell,
O motra ime!*

Edhe figura e mallit zë një vend të vecantë në poemën “Kamadeva”, është një nga figurat që shprehin gjakimin, ëndërrimin e përmallshëm, dëshirën e zjarrtë për vashën, ku shumë qartë vërehet në vargjet e poemës:

*...Po sot as dhe me s'di,
Jam a s'jam gjallë,
Se mua kurrsesi,
S'ma nxore malle*

...Përpiqem e lëngo

⁹⁵ Meri Lalaj, “Lasgushi në Poradec”. UEGEN, Tiranë 2017, f.24

*Me mall të trerë,
Kërkoj e ligjëroj
Derë me derë;*

*...O natë! O ëmbëlsi!
Limer i fshehtë!
O mall! O dashuri!
Përgjithëjetë!*

Tërë poezia e Lasgushit mbështetet në figura me gjuhën e zemrës dhe me origjinalitetin e tij duke punuar vazhdimisht për të përsosur edhe formën edhe strukturën e poezisë deri në fund të jetës së tij.

Poradeci është poet mendimtar, me një kuriozitet të fshehtë e magjik, andaj i përkushtohet me aq vullnet edhe shkrimeve të tij, të cilat nuk janë me numër të shumta, mirëpo pothuajse të gjitha janë art në vete, e njëra nga këto shkrime është edhe poema “Kamadeva”, e cila në vetvete ka një kuriozitet të fshehur, apo të themi diçka të fshehtë kur poeti herë e shpreh dashurinë e personazheve në botën reale e herë në botën e përjetësisë, duke e bërë të paqartë se në cilën botë jeton dashuria e tyre, duke mbajtur kështu në një kuriozitet edhe lexuesin, i cili në përfundim të poemës kupton se dashuria e tyre kthehet në botën reale, duke kaluar herë në botën reale e herë në atë imagjinar, duke kaluar edhe hapësira të mëdha kozmike.⁹⁶

Dashuria e zjarrtë e dy të rinjve shfaqet edhe me figurën e krahasimit, ku autori krahason djegien nga dashuria me djegien e qirinjve të cilët kanë të përbashkët flakën, sic e kanë të përbashkët edhe dashurinë dy të rinjtë.

*Si dy qirinj n'altar,
Flakëbashkuar,
Q'o djeg e tret me zjarr
Drit' e pashuar,
Dy shpirtat, në valim
Dyke soditur,
Kënduan me adhurim
Flakëzhuritur;*

⁹⁶ Sabri Hamiti, “Letërsia moderne” – Vepra letrare. Prishtinë - Faik Konica, 2002, f.193

Poema “Kamadeva”, ndahet në tri pjesë, ku në secilën i këndohet vashës, pjesa e parë përshkruan dashurinë e vashës dhe poetit, pjesa e dytë përshkruan prapë dashurinë e dy të rinjve, por tani në një botë tjetër, nga bota imagjinare dhe prapë mbetet i pakënaqur nga kjo botë dhe kthehet në botën reale, sepse njeriu është qenie që asnjëherë nuk është e kënaqur.

...O natë! O ëmbëlsi!

Limer i fshehtë!

O mall! O dashuri!

Përgjithëjetë!

Megjithatë mënyra se si ai i është qasur dashurisë, dëshmon për luftën brenda tij për të mbijetuar ndaj çdo lloj force. Pas lufte, kur regjimi përpiqej ta harronte me çdo kusht, ai shkruante brilantet më të vyera për erotikën si “Kamadeva”, apo filozofike-alegorike sic është “Ekskursioni teologjik i Sokratit”, por as larg nga to nuk mbetet edhe poema me temë historiko-atdhetare “Mbi ta”.

3.5.3. Poema me temë epiko-historike

Trimëria e popullit shqiptar paraqitet në gjithë poemën “Mbi ta”, në të cilën duket qartazi se autori ka dashur që të tregojë një ngjarje historike vërtet të ndodhur, me emra real të historisë, duke synuar që të paraqesë në vepër letrare me ngjarjet historike.

Duke e shqipësuar poezinë deri në skaj, duke e harruar nga fjalët e huaja deri në fund, duke e bërë më shqip se çdo poet tjetër i letrave shqipe deri atëherë në përgjithësi, Lasgushi na del vetvetiu atdhetar i flaktë, sepse bëri poezi aq shqipe saqë nuk e ndiente nevojën të thoshte vetë se ja çfarë shkruaj unë, ja se sa poezi me motive patriotike shkruaj unë, por atë do ta thonë të tjerët, kritika e mirëfilltë, lexuesit pa ngarkesa politike, me siguri në të ardhmen, me një të ardhme jo edhe aq të largët – do të mendonte ai... E Lasgushi ka pasur të drejtë, koha i ka dhënë të drejtë mendimit të tij të pathënë, heshtjes së tij të gjatë.

Koha i ka dhënë të drejtë edhe lexuesi i tij është i bindur, sidomos me poemën e tij me motive epiko-historike “Mbi ta”. Nga vetë titulli i poemës “Mbi ta”, shfaqet ideja e autorit për të

qenë mbi armikun, mbi ata të cilët sulmojnë popullin shqiptar, trojet e tyre shumëshekullore, sepse populli shqiptar nuk mposhtet lehtë.⁹⁷

Edhe pashallarët si figura negative në këtë poemë ngrisin figurën e Dedë Gjo Lulit e Mehmet Shpendit, duke ardhur në përfundim se dy trimat përveç fuqisë e trimërisë që i karakterizon, atyre iu vije në ndihmë edhe territori i papërshtatshëm për të luftuar e fituar në trojet shqiptare, e në këtë mënyrë duke u përpjekur ta shfajësojë vetveten para Sulltanit.

*“Me faj e turp, Sulltan-Baba,
Po kthehem i ngarkuar,
Se Mehmet Shpendi ish katalla,
S’do mbret për ta sunduar;*

*As Ded Gjo ‘Luli s’do në Hot
Mbi krepat tmerrimtare,
Ku as shqiponjat s’ngjiten dot,
Veq djajtë shqiptarë;”*

Lasgushi shkrimin e tij e mbështet në një shkrim të menduar mirë, e jo të ngutshëm, të përkushtuar dhe doemos e tillë është edhe poema “Mbi ta”. Me shkrimin e poemës epiko-historike, autori bën një kalim nga lirika në epikë duke treguar ngjarje e ndodhi dhe duke zënë një vend të rëndësishëm edhe shkrimi i figurshëm.

3.6. Përfundime mbi poemat e Lasgushit

Për poemat e Lasgushit mendoj se kurrë nuk do të thuhet fjalë përfundimtare, sepse të tri poemat e tij në përgjithësi, me plot bukuri dhe me “ndjenjat më labirintike” të brendshme, sidomos ajo alegorike, por edhe ajo e dashurisë janë një det i pafund, në të cilat sa më thellë që të zhytesh aq më i paarritshëm është fundi i tyre, por që të josh gjithnjë e më shumë t’ia njohësh të fshehtat e tyre, e që është një sfidë e madhe, sepse shkrimet e Lasgush Poradecit sado që i studion, gjithmonë del dicka që mendon se ke lënë pa e qartësuar apo pa e thënë për të, sepse vetë shkrimet e tij janë një botë në vete që kërkon një përkushtim më të madh për t’i studiuar e qartësuar.

⁹⁷ Kujtim M. Shala, “Lasgushi i përjetshëm”. Faik Konica – Prishtinë, 1999, f.79.

Tri poemat, të cilat janë temë e kësaj pjese të punimit: “Kamadeva”, “Ekskursioni teologjik i Sokratit” dhe “Mbi ta”, ndonëse janë shkruar në një kohë të rëndë për autorin, në kohën kur e kishte mundur pleqëria dhe kur ishte harruar nga koha, janë vepra të cilat edhe një herë përtërijnë ndjenjat dhe shkrimet e rinisë së autorit, vrullin e tij për dashurinë, ndjenjat, mallin, të dashurën, trimëritë e heronjve, etikën, moralin, e gjithë kjo përmes shkrimit të figurshëm, gjuhës së pastër shqipe.

Përfundimi

Ky punim trajtoi botën poetike të Lasgush Poradecit, bota të cilën e ofron poeti është e gjerë, e thellë, me krijimin e yjeve në qiell, me nënbotë me prezencën okulte të Zotit, të frymës, qëllimit, tek historia, epika, dashuria dhe deri tek liqeri, mëngjeset, mbarimet e vjeshtës, me zogjtë dhe lulet, dashurinë dhe mërgimin shpirtëror, mallin vjershëtorit.

E gjithë krijimtaria e Lasgush Poradecit ka për synim që të përshkruajë, duke filluar nga gjërat më të thjeshta siç janë gjërat që e rrethojnë e duke vazhduar deri tek studimet më të hollësishme, apo shkrimet që mbështeten në një shkrim të figurshëm, duke tentuar vazhdimisht që të përsosë shkrimin e tij, në mënyrë që pastaj të jetë e përjetshme dhe të recitohet, këndohet, studiohet brez pas brezi. Duket se ky ka qenë qëllimi kryesor i Lasgush Poradecit, i cili në një farë forme edhe ja ka arritur ta bëjë.

Lasgushi në shkrimet e tij përdori gjuhën e zjarrtë, fjalët e reja, metaforat, alegoritë, ironitë, duke bërë këtë autor si themeluesin e letërsisë moderne shqiptare, por vepra e tij edhe sot lexohet si një vepër që ngjallë imagjinatën e të qetëson shpirtin.

Poeti ynë i madh, Lasgush Poradeci, jetoi gjatë i harruar në atdheun e vet dhe i mërguar në vetvete, në dhembjet e veta, mirëpo gjatë gjithë kësaj kohe shkroi vepra që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në letërsinë shqiptare.

Poezia e Lasgushit është poezi që përmban para se gjithash estetikën, bukurinë qoftë përshkruese, e qoftë poezi që të ofron kënaqësi të papëshkruar, poezi që herë-herë të bën të mendosh se poezia shkruhet edhe pa pasur një qëllim të caktuar angazhues, përcjellëse idesh, por poezi që paraqet peizazhet e tabllot e gjalla të natyrës dhe njeriun që jeton në të, të atij njeriu me një botë shumë të pasur e të thellë shpirtërore e mendore, imagjinare.

Sa i përket poemave të Lasgushit mendoj se kurrë nuk do të thuhet fjalë përfundimtare, sepse të tri poemat e tij në përgjithësi, me plot bukuri dhe me “ndjenjat më labirintike” të brendshme, sidomos ajo alegorike, por edhe ajo e dashurisë janë një det i pafund, në të cilat sa më thellë që të zhytesh aq më i paarritshëm është fundi i tyre, por që të josh gjithnjë e më shumë t’ia njohësh të fshehtat e tyre, e që është një sfidë e madhe, sepse shkrimet e Lasgush Poradecit sado që i studion, gjithmonë del diçka që mendon se ke lënë pa e qartësuar apo pa e thënë për të, sepse vetë shkrimet e tij janë një botë në vete që kërkon një përkushtim më të madh për t’i studiuar e qartësuar. Tri poemat, të cilat janë temë e kësaj pjese të punimit:

“Kamadeva”, “Ekskursioni teologjik i Sokratit” dhe “Mbi ta”, ndonëse janë shkruar në një kohë të rëndë për autorin, në kohën kur e kishte mundur pleqëria dhe kur ishte harruar nga koha, janë vepra të cilat edhe një herë përtërijnë ndjenjat dhe shkrimet e rinisë së autorit, vrullin e tij për dashurinë, ndjenjat, mallin, të dashurën, trimëritë e heronjve, etikën, moralin, e gjithë kjo përmes shkrimit të figurshëm, gjuhës së pastër shqipe.

Mund të themi se Lasgush Poradeci qëndron në reformimin që ai i bëri lirikës në poezinë shqipe si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Lasgushi kështu krijoi poetikën origjinale, në të cilën ngrihet një botë emocionesh, idesh e idealesh, në të cilën vendosi botën shqiptare.

Si përfundim mund të rekomandohet që në punimet e ardhshme për punën e Lasgushit të thellohet më gjerësisht në analizën e dy vëllimeve: “*Vallja e Yjeve*” dhe “*Ylli i Zemrës*”.

Gjithashtu gjatë realizimit të punimit ka pasur mungesë të burimeve nga interneti, prandaj rekomandohet që të bëhet një freskim i materialin për Lasgushin dhe vëllimet e tij, në mënyrë që lexuesit e tij të kenë sa më shumë qasje për të, pasi kjo formë e kërkimit të burimeve është më e lehtë dhe e praktikueshme nga shumica e njerëzve.

Vepra e Lasgush Poradecit në poezi, por edhe shënimet e ndryshme apo ditarët, japin mundësi të një shqyrtimi edhe më të gjithanshëm se kaq. Prandaj rekomandohet të bëhet një analizë më e thellë në rrafshin fonologjik, morfologjik, sintaksor apo semantik pasi struktura e krijimeve të tij poetike është e vlefshme.

Literatura

1. Eldon Gjikalaj, Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradecit, “Naimi”, Tiranë, 2010.
2. Emin Kabashi, Lasgush Poradeci: Jeta dhe vepra. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1997.
3. Ilir Shyta, Bibliografi e autorizuar për jetën dhe veprën letrare të Lasgush Poradecit.
4. Ilir Shyta, “Receptimi i poezisë së Lasgush Poradecit”. Tiranë, 2015 (Disertacion).
Marrë në: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2016/01/Doktoratura-Ilir-Shyta-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Letersise.pdf#page=104&zoom=100,394,120> (qasja e fundit 10.01.2020)
5. Lasgush Poradeci, “Ylli i zemrës”. Rilindja, Prishtinë, 1990.
6. Lasgush Poradeci, “Vallja e yjve”, Konstancë, 1933.
7. Sabri Hamiti, “Tematologjia”, Prishtinë, 2005.
8. Nysret Krasniqi, “Autori në letërsi”, AIKD. Prishtinë, 2009.
9. Hysen Matoshi, “Stilet në letërsinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore”, Prishtinë, 2009.
10. Ali Aliu, “Shtengim metafore”. Toena, 2006.
11. Eqrem Çabej, “Mbi poezinë e Lasgush Poradecit”.
12. A. Mushulin, “Historia e kohës së vjetër”. Tiranë, 1950
13. Irving Edman, “Platon”.
14. J. F. Stone “The trial of Sokrates”.
15. Frida Idrizi, “Vepra letrare e L. Poradecit, Parathënia”, Tiranë, 1990.
16. Lasgush Poradeci “Vepra letrare”, Tiranë, 1990.

17. Eqrem Cabej, “Mbi poezinë e Lasgush Poradecit”.
18. Sabri Hamiti, “Studime letrare”. Prishtinë, 2003.
19. Ali D. Jasiqi, “Poezia popullore dhe lirika e Lasgush Poradecit”, Revista letrare – JETA E RE.
20. Jeta e Re, Revistë letrare, “Lasgush Poradeci”, Prishtinë 1999.
21. Mensur Raifi, “Lasgushi, Noli, Migjeni”, Rilindja, 1986.
22. Moikom Zeqo, “Të dhëna të reja për Lasgush Poradecin”. Bashkimi Tiranë, 1991.
23. Sabri Hamiti, “Lasgushi qindvjeçar”, Prishtinë, 1999.
24. Sami Krosi, “Filozofia e jetës në poezinë e Lasgush Poradecit”. Shkup, 1998.
25. Petraq Kolevica, “Lasgushi më ka thënë”. 8 Nëntori, Tiranë, 1992.
26. Mirlinda Krifca, “Dialog me poezinë e Lasgush Poradecit”. Shkup, 2000.
27. Sabri Hamiti, “Letërsia moderne” – Vepra letrare. Prishtinë - Faik Konica, 2002.
28. Sabri Hamiti, “Lasgush Poradeci – Vdekja e Nositet”. Prishtinë, Rilindja, 1986.
29. Meri Lalaj, “Lasgushi në Poradec”. UEGEN, Tiranë 2017.
30. Kujtim M. Shala, “Lasgushi i përjetshëm”. Faik Konica – Prishtinë, 1999.